



**Komuna e
Podujevës**

2012/2017

...për qytetin tim!

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis



Plani Lokal i Veprimit në Mjedis

2012/2017



Komuna e Podujevës

Projekti është financuar nga:



Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Zbatimi i projektit është mbështetur edhe nga:



MMPH dhe MAPL.

Ky projekt është zbatuar nga:



REGIONAL ENVIRONMENTAL CENTER

Qendra Rajonale e Mjedisit, REC – Zyra në Kosovë.

Botim i Qendra Rajonale e Mjedisit, REC – Zyra në Kosovë.
<http://kosovo.rec.org/>; <http://www.rec.org/>

PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2012/2017

Copyright © 2012 REC

Të drejtat e botimit të këtij publikimi i mban:

Qendra Rajonale e Mjedisit, REC – Zyra në Kosovë

Design & Layout: Arben Grajqevci (Rrjeti)

Shtypi: RRJETI, Prishtinë

Përmbajtja

Ç'është REC?	8
Fjala e Kryetarit të Komunës.....	9
Fjalorthi i shkurtesave.....	10
Akterët dhe përgjegjësitë e PLVM-së.....	11

Pjesa 1

I. HYRJE	15
Detyrimet ligjore për hartimin e PLVM-së	15
Plani lokal për Veprim në Mjedis ka për qellim të:	15
Metodologjia e përgatitjes së PLVM-së	16
Dokumenti është i hartuar mbi tri baza kryesore:.....	17

Pjesa 2

I. Profili i Komunës	19
1.1 Historiku i shkurtër	19
1.2 POZITA GJEOGRAFIKE	19
1.3 Klima	20
1.4 Demografia	20
1.5 Pasuritë natyrore	21
1.5.1 Minerale	21
1.5.2 Pyjet	21
1.5.3 Tokat bujqësore	21
1.5.4 Burimet ujore	22
1.6 Ekonomia.....	23
1.6.1 Industria	23
1.6.2 Bujqësia	23
1.6.3 Energjia elektrike	27
1.6.4 Turizmi dhe hoteleria	27
1.6.5 Biznesi privat	29
1.7 Infrastruktura dhe shërbimet publike	29
1.7.1 Ujësjellësi dhe kanalizimi	29
1.7.2 Menaxhimi i mbeturinave.....	30
1.7.3 Infrastruktura rrugore dhe transporti publik	31
Infrastruktura rrugore	31

1.7.4 Ndriçimi publik	33
1.7.5 Shërbimet e telekomunikimit dhe mediat	33
1.8 Shërbimet sociale	33
1.8.1 Arsimi	33
1.8.2 Shëndetësia	34
1.8.3 KULTURA, RINIA DHE SPORTI	35
1.8.4 Trashëgimia kulturore dhe historike	35

Pjesa 3

II. GJENDJA E MJEDISIT	37
2.1 Menaxhimi i ajrit	37
2.1.1 Emisionet e stacionuara	37
2.1.2 Emisionet e lëvizshme	37
2.1.3 Cilësia e ajrit	38
2.1.4 Identifikimi i problemeve dhe rekomandimet.....	38
2.2 Menaxhimi i ujit	38
2.2.1 Furnizimi me ujë të pijshëm	38
2.2.2 Cilësia e ujit të pijshëm dhe monitorimi	39
2.2.3 Kërkesa për ujë të pijshëm	39
2.2.4 Potencialet për zgjerim kapacitetesh për ujë të pijshëm	39
2.2.5 Menaxhimi i ujërave të ndotura (Urbane dhe industriale).....	39
Menaxhimi i ujërave të ndotura- rekomandimet	41
2.2.6 Cilësia e ujit të lumenjve dhe shkalla e ndotjes	41
2.3 Menaxhimi i mbeturinave	43
2.3.1 Mbeturinat urbane	43
2.3.2 Deponitë formale dhe informale	43
2.4 Zhvillimi urban dhe shfrytëzimi i tokës	44
2.4.1 Planifikimi hapësinor Komunal	44
2.4.2 Toka si medium mjedisor	46
2.4.3 Bujqësia	47
2.4.4 Vendbanimet joformale	47
2.4.5 Rekomandimet	47
III. Biodiversiteti dhe trashëgimia natyrore	51
3.1 Biodiversiteti	51
3.2 Trashëgimia natyrore	52

Pjesa 4

Pesë problemet kryesore në fushën e mjedisit në Komunën tuaj?	55
---	----

Pjesa 5

VI. Plani i Veprimit – Projektet prioritare	57
---	----

Pjesa 6

VII. PLANI I VEPRIMIT.....	63
Menaxhimi i Tokës, Biodiversiteti	63
Menaxhimi i ujërave të zeza.....	68
Menaxhimi i ujit të pijshëm	74
Menaxhimi i mbeturinave	78



Ç'është REC?

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) është organizatë ndërkombëtare neutrale, joavokuese dhe jofitimprurëse, e cila mbështet zgjidhjen e problemeve mjedisore në Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL). Kjo qendër e përmbush misionin duke promovuar bashkëpunim ndërmjet Organizatave Jo Qeveritare (OJQ), qeverive, bizneseve si dhe personave tjerë kyç mjedisor si dhe duke përkrahur këmbimin e lirë të informatave dhe pjesëmarrjen publike në vendimarrjen për mjedis. REC është themeluar në vitin 1990 nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Komisioni Evropian dhe Hungaria.

Aktualisht, REC bazohet ligjërisht në Kartën e vet, nënshkruar nga qeveritë e 29 vendeve dhe Komisioni Evropian dhe në një marrëveshje ndërkombëtare me qeverinë e Hungarisë. Zyra qendrore e REC-ut është në Szentendre, Hungari si dhe zyrat fushore dhe zyrat e shteteve në 17 vendet përfituese.



Fjala e Kryetarit të Komunës

Fjala e Kryetarit të Komunës

Ndërgjegjësimi qytetarë dhe gjykimi e vlerësimi me realizëm për pasjen sot, për mirë kujdesin dhe mbarështimin e veprimit e të jetuarit në harmoni me mjedisin, e bënë edhe përgjegjësinë edhe të qenit të vetëdijshëm për ruajtje e kultivim të tij, si vlerë e epërme, për ne e për trashëgimi ndër breza.

Ato që i dimë, tjerat që do ti shënjojmë dhe mësojmë për qenien e mjedisit ku jetojmë jetën, është tabani ku institucionet e shtetit, pa vonuar, do ti përparësojnë planet, përqendrojnë hapat, aktivitetet dhe masën e veprimit.

Ambienti ynë, gjendja e tij aktualisht, na obligon për veprime të menjëhershme mbi praktika të provuara dhe mbi vlerësim ekspertësh, në rritje të cilësisë së mjedisit, por edhe në motivim të angazhimit të individit qytetar e të mobilizimit të shoqërisë në përballimin e sfidës; Tashti!

Konteksti i zhvillimit sot e këtu, e ka imponuar domosdonë e mbarimit të Planit Lokal për Veprim në Mjedis, dokument ky, besoj me peshë, tani dhe në vijimësi, në shmangien e ecjes pa vizion e pa koncept modern për jetën e shëndetshme e mjedisin, si vlerë e cilësi, si humanizëm e civilizim.

Ne me detyrimin që kemi, bashkëpunimi me partnerët, si Sida dhe REC, që bashkuan me vullnetin e përkushtimin tonë, përvoja më të mira në këtë rrafsh, sollën për rezultat këtë Plan Veprimi në mjedis, e që, me gjithë koston që do, sigurojmë angazhim në zbatim të tij dhe efekte pozitive e jetëgjata për një ambient cilësorë.

Agim VELIU
Kryetar i Komunës

Fjalorthi i shkurtesave

AKMM	- Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
APK	- Agjencioni Pyjor i Kosovës
BE	- Bashkësia Evropiane
DSHMS	- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Ha	- Hektar
IKMN	- Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
IUCN	- Unioni Botëror për Mbrojtjen e Natyrës
KK	- Kuvendi Komunal
KRM “Pastrimi”	- Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi”
KUR “Prishtina”	- Kompania e Ujësjetës Rajonal “Prishtina”
MMPH	- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MBPZHR	- Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
NJOU -	- Njësia Operative e Ujësjetës në Podujevë
OJQ	- Organizata Joqeveritare
PKVM	- Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
PLVM	- Plani Lokal i Veprimit në Mjedis
PZHK	- Plani Zhvillimor Komunal
PZHU	- Plani Zhvillimor Urban
PRRU	- Plani Rregullativ Urban
QPS	- Qendra për Punë Sociale
REC	- Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore
SKM	- Strategjia e Kosovës për Mjedis
SKP	- Strategjia e Kosovës për Pyjet
UNDP	- Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNESCO	- Programi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë
VNM	- Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	- Vlerësimi Strategjik i Mjedisit

Akterët dhe përgjegjësitë e PLVM-së

Ky Projekt është implementuar nga:

Qendra Rajonale e Mjedisit, REC (Regional Environmental Center) - Zyra në Kosovë.

Koordinator i REC për PLVM:

Valmir MUSTAFA

Komuna e PODUJEVËS

Koordinator i Komunës për PLVM:

Rizah MUÇOLLI

Anëtarët e Trupit Koordinues:

- | | |
|---------------------|---|
| 1. Mehmet Gashi | - Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit |
| 2. Isuf Latifi | - Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa |
| 3. Faik Muçiqi | - Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim |
| 4. Fidan Rekalu | - Këshilltar i asamblesë komunale nga LDK |
| 5. Naim Qunaku | - Këshilltar i asamblesë komunale nga PDK |
| 6. Ismajl Abdullahu | - Këshilltar i asamblesë komunale nga AAK |
| 7. Rizah Muçolli | - Koordinator i komunës për PLVM |

Personat dhe grupet e ndryshme që janë përfshirë në hartimin e PLVM-së për Komunën e Podujevës:

1. Rizah Muçolli - Koordinator i komunës për PLVM
2. Ylber Salihu - Zyrtar i Integritimeve Evropiane
3. Naime Podvorica - Zyrtare për Barazi Gjinore
4. Arjeta Podvorica - Koordinator e njësitit për të drejtat e njeriut
5. Avni Shabani - Kryetar i Shoqatës të Biznesit Llapian
6. Shpend Sopu - Kryetar i OJQ “Ekovizioni”
7. Rasim Fejza - Shef i Shërbimeve Publike
8. Naser Kajtazi - Menaxher në KUR “Prishtina” dhe Kryetar i shoqatës së Bletarëve “Llapi”
9. Shaban Beselica - Menaxher në KRM “Pastrimi “ njësi operative në Podujevë
10. Eset Abdullahu - Inspektor i Mjedisit
11. Fatmir Uka - Inxhinier në drejtorin për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit
12. Florie Mani - Inxhinier në drejtorin për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit
13. Mirvete Jaha - Inxhinier në drejtorin e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
14. Xhafer Sekiraqa - Zyrtar për Bujqësisë
15. Faik Kadriu - Shef i Sektorit të Pylltarisë
16. Muhamet Maloku - Arsimitar i Biologjisë dhe lëndëve mjedisore
17. Ejup Babatinca - Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik
18. Ardiana Hyseni - Aktiviste e Ekovizioni – it
19. Halit Vërshevc - Menaxher i Zyrës për Informim dhe Siguri në Bashkësi
20. Azem Osmani - Zyrtar për Informim

Baza ligjore për hartimin e PLVM-së



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Në bazë të nenit 12.2 pika d lidhur me nenin 17 pika e të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, nenit 24 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit nr. 03/L-025 dhe nenit 19 pika e të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shtator 2011, mori:

VENDIM

PËR HARTIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT NË MJEDIS

Neni 1

Me qëllim të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm komunal në Komunën e Podujevës bëhet hartimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis.

Neni 2

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis duhet të përmbajë të gjitha elementet themelore të cilat janë përcaktuar në nenin 24 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit nr. 03/L-25 dhe elementet e Planit të Kosovës për Veprim në Mjedis 2006-2010.

Neni 3

Kryetari i Komunës, në funksion të hartimit të Planit Lokal të Veprimit në Mjedis, ngrit trupin koordinues dhe grupin punues.

Neni 4

Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në bashkëpunim me Drejtoritë tjera të Administratës së Komunës, Kompanitë Publike, OJQ-të dhe Komunitetin, siguron të dhënat për përgatitjen e Planit Lokal për Veprimin në Mjedis.

Neni 5

Plani Lokal për Veprimin në Mjedis, në përputhje me këto udhëzime dhe nën kushtet dhe parametrat e ligjit të cekur, duhet të zbatohet sipas dispozitave ligjore, rregulloreve dhe normave përmes Buxhetit të Komunës së Podujevës.


Neni 6

Projekti prioritar që do të dalë nga dokumenti i Planit Lokal për Veprimin në Mjedis, do të bashkëfinancohet nga Komuna e Podujevës me participim financiar prej 20 mijë (njëzet mijë) euro, dhe nga Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore (REC) me participim prej 40 mijë (katërdhjetë mijë) euro.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi me ditën e miratimit.

Nr. 01/157-501
Podujevë,
28 shtator 2011



Kryesuesi i Kuvendit
Hazir Raçi

Legjislacioni i Republikës së Kosovës në fushën e mbrojtjes te mjedisit harmonizuar me standardet evropiane që është përdorur si referencë për përgatitjen e PLVM-së.

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (2009/03-L-025)

- Ligji për Mbeturinat (2005/02-L30)
- Ligji për Mbrojtjen e ajrit (2004/30)
- Ligji për Mbrojtjen e bimëve (2006/02-L95)
- Ligji për Mbrojtjen e natyrës (2005/02-L18)
- Ligji për Mbrojtjen e varieteteve të bimëve (2007/02-L98)
- Ligji për Mbrojtjen nga zhurma (2007/02-L102)
- Ligji për Mbrojtjen nga zjarri (2006/02-L41)
- Ligji për Bujqësi dhe zhvillim rural (2009/03-L-98)
- Ligji për Bujqësi organike (2007/02-L122)
- Ligji për Gjuetinë (2005/02-L53)
- Ligji për Plehrat Artificiale (2003/10)
- Ligji për Planifikim Hapësinorë (2003/14)
- Ligji për Pyjet (2004/29)
- Ligji për Ujërat (2004/24)
- Ligji për Ujitjen e tokave bujqësore (2005/02-L9)
- Ligji për Vlerësimin e ndikimit në mjedis (2009/03-L-024)
- Ligji për Vetëqeverisje Lokale (2008/03-L040)
- Ligji për Zonat e veçanta të mbrojtura (2008/03-L039)
- Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (2009/03-L-015)
- Udhëzimi administrativ Nr 02/07 për mbeturina nga Bateritë dhe Akumulatorët
- Udhëzimi administrativ Nr 03/07. Për administrimin e vajrave të përdorura mbeturinë
- Udhëzimi administrativ për automjete e hedhura dhe mbeturinat e tyre, 20.12. 2006
- Udhëzimi administrativ Nr. 12/2008 për asgjësimin e mbeturinave medicinale
- Udhëzimi administrativ Nr. 05/2008 për administrimin me mbeturinat medicinale
- Udhëzimi administrativ Nr. 05/2009 për administrimin e mbeturinave publike
- Udhëzimi administrativ Nr. 04/2009 për ndëshkime dhe gjoba mandatore
- Planin Kombëtar për Veprim në Mjedis i Kosovës, 2006- 2010

Pjesa 1

I. HYRJE

Planet Lokale të Veprimit në Mjedis (PLVM) janë dokumente të politikës mjedisore vendore, të cilat paraqesin prioritete mjedisore dhe listën e veprimeve për zgjidhjen e tyre. Përgatitja e këtyre planeve zhvillon më tej aftësitë e pushtetit vendor dhe subjekteve të tjera të interesuara për mjedisin dhe komunitetin.

Gjithashtu, PLVM nxit bashkëpunimin midis shoqërisë civile, publikut, pushtetit vendor dhe atij qendror, biznesit dhe subjekteve të tjera mjedisore, duke përkrahur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.

Detyrimet ligjore për hartimin e PLVM-së

Përgatitja e PLVM-së është e detyrueshme për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore që kanë filluar procesin e asocim-stabilizimit dhe që synojnë të integrohen në BE. Për vendin tonë, hartimi i këtyre planeve nga qeverisjet vendore është detyrë ligjore, e përcaktuar në Nenin 24 të **Ligji për mbrojtjen e mjedisit Nr.03/L-25**

Plani lokal për Veprim në Mjedis ka për qëllim të:

- Zgjidh problemet mjedisore nëpërmjet identifikimit të prioriteteve dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë aktorët e mundshëm për përcaktimin e këtyre veprimeve dhe krijimin e strategjive për zbatimin e tyre në mënyrë efektive, të ndërthurura sipas një Plan Veprimi.
- Zhvillojnë shoqërinë civile nëpërmjet forcimit të koordinimit dhe komunikimit ndërmjet sektorëve të ndryshëm në komunitet, duke sjellë së bashku përfaqësues të komuniteteve të ndryshme që përfaqësojnë interesa të ndryshme në këto komunitete, përfshirë autoritetet vendore, përfaqësues të OJQ-ve, biznesin, shkencëtarë, duke shpjeguar teknikat specifike që organizatorët lokalë mund të përdorin për të përcaktuar aktorët kryesorë të procesit, të rrisin pjesëmarrjen dhe kontributin e publikut në proces, për rekrutimin dhe punën me vullnetarët dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet grupeve të interesuara dhe organizatave.
- Rrisin aftësitë e qeverisjes vendore dhe komunitetit për paraqitjen e elementëve thelbësorë të planit të veprimit të komunitetit, duke vlerësuar problemet dhe mundësitë komunitare, duke organizuar komitete qytetare, duke përfshirë publikun, përcaktimin e prioriteteve, hartimin e strategjive dhe zhvillimin e një Plan Veprimi.

- Rrisin shkëmbimin e informacionit në nivel lokal nëpërmjet sjelljes së shembujve dhe modeleve nga plane të mëparshëm të komuniteteve nga të cilat pjesëmarrësit mund të nxjerrin ide dhe teknika të zbatueshme në rastet konkrete të tyre, të mbledhin me kujdes informacion mbi gjendjen e tanishme të mjedisit.
- Japin zgjidhje konkrete për problemet e komunitetit me anë të shkëmbimit të përvojave lidhur me përdorimin e aftësive në analiza, planifikime, debate dhe vlerësime që janë thelbësore për një veprim të komunitetit efektiv. Duke u dhënë pjesëmarrësve mundësinë për të vënë në praktikë punën në grupe, duke u marrë me zgjidhjen e problemeve praktike nëpërmjet ndërveprimit të grupeve të vogla të punës.

Metodologjia e përgatitjes së PLVM-së

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Fushë-Kosovës u hartua përgjatë një periudhe njëvjeçare dhe në hartimin e tij janë përfshirë akterët të pushtetit vendor dhe komuniteti i gjerë. Për këtë u ngrit një grup pune me specialistë të fushave të ndryshme (ambientalizëm, arkitekturë, turizëm, shëndetësi, arsim, sport, trashëgimi kulturore, etj.), të cilët punuan në bashkëpunim me ekspertë tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë për hartimin e PLVM-së.

Së pari, është bërë trajnimi i përfaqësuesve të komunave të cilët janë të futur në projekt në aspektet e hartimit të PLVM-së dhe gjetjes së mjeteve shtesë për realizimin e aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë mjedisore.

Në kuadër të projekti për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM), është bërë një anketim i qytetarëve të Komunës së Fushë-Kosovës. Ka qenë një numër i konsiderueshëm i pyetësorëve, të cilët kanë ndihmuar dhe orientuar grupin në mënyrë më të drejtë në zgjedhjen e fushave prioritare. Një falënderim për këtë i takon qytetarëve të Komunës së Fushë-Kosovës dhe shoqërisë civile, e cila në procesin e anketimit të respondentëve ka ndihmuar që procesi i anketimit të jetë i suksesshëm. Për të pasur një përfshirje sa më të gjerë dhe për të marrë mendimet e komunitetit dhe shoqërisë civile, janë organizuar edhe debate publike dhe debate në media.

Dokumenti i është paraqitur Kuvendit Komunal të Fushë-Kosovës dhe është miratuar prej tij më 18.06.2012, duke e kthyer atë në një dokument zyrtar pune. Për të ndihmuar procesin e zbatimit, një shumë investimesh të akorduara nga projekti do të përdoren për të zbatuar pjesë të Planit.

Procesi themelor i hartimit të PLVM-së ndahet në faza, të cilat lidhen njëra pas tjetrës:

- a) Nënshkrimi i marrëveshjeve dhe memorandumëve REC – Komunë;
- b) Aktivitetet përgatitore;
- c) Formimi i trupit koordinues TK;
- d) Formimi i grupit punues GP;
- e) Trajnimi i GP
- f) Vlerësimi i gjendjes së mjedisit;
- g) Anketimi i qytetarëve;
- h) Hartimi i vizionit të komunitetit;
- i) Caktimi i prioriteteve;
- j) Hartimi i planit të veprimit për fushat prioritare dhe;
- k) Caktimi i prioriteteve në realizimin e planit të veprimit.

Dokumenti është i hartuar mbi tri baza kryesore:

1. Analiza e gjendjes mjedisore

Paraqet një analizim të hollësishëm të situatës për të gjitha çështjet e marra në konsideratë nga plani, duke e paraqitur atë në të gjitha aspektet e tij dhe të ndërlidhura ndërmjet tyre. Kjo analizë shërben për të pasur një ide më të qartë të problemeve mjedisore, të cilat shqetësojnë Komunën e Fushë-Kosovës.

2. Lista e problemeve mjedisore

Problemet mjedisore paraqiten sipas një matrice të paracaktuar, e cila jep në mënyrë të detajuar të gjithë treguesit për identifikimin e një problemi. Pjesët më të rëndësishme të kësaj matrice janë shkaktarët e problemit dhe prioriteti për secilin.

3. Plani i veprimeve për zgjidhje

Ky kapitull është pjesa më e rëndësishme e Planit, pasi paraqet të gjitha veprimet dhe projektet e mundshme për zgjidhjen e problemeve mjedisore të përcaktuara.

Kjo matricë u shërben autoriteteve vendore për të hartuar projektet konkrete dhe për sigurimin e fondeve nga donatorët.

VIZIONI

‘Komuna e Podujevës - vend me mjedis të pastër, të menaxhuar mirë, në funksion të mirëqenies dhe të shëndetit të qytetarëve’.

Pjesa 2

I. PROFILI I KOMUNËS

1.1 Historiku i shkurtër

Treva e Llapit është herët e banuar për shkak të kushteve të volitshme natyrore. Edhe pse shumë monumente që e dokumentojnë vjetërsinë janë zhdukur, megjithatë kanë mbetur disa. Dokumente të tilla janë burimet arkeologjike, si: themelet e kalave, varrezat, tjegullat, armët, si dhe emërtimet e ndryshme. Banorët më të vjetër të Llapit ishin fisi ilir-dardanët. Vendbanimet e para ishin ngritur pranë lumenjve. Degë ekonomike ishin: gjuetia, blegtoria etj. Gjatë pushtimit të romakëve kjo hapësirë ka pësuar mjaft dëme sidomos pjesët e fortifikuara. Qendër e rëndësishme e kësaj kohe ishte Vendenisi (Gllamniku)¹



Figura 1. Sarkofagu i gjetur në Gllamnik-Vendenisi



Figura 2. Pamje e vendbanimit - Podujevë

1.2 POZITA GJEOGRAFIKE

Komuna e Podujevës shtrihet në pjesën verilindore të Kosovës dhe përbëhet nga fushë-gropa e Llapit, pjesët kodrinore-malore të bjeshkëve të “Albanikut” në perëndim dhe maleve kosovare në lindje²

Në aspektin e trafikut dhe të komunikimit paraqet një transversale të rëndësishme, si pjesë e korridorit që lidhë Kosovën me bregdetin dhe pjesët tjera të Gadishullit Ballkanik.

Komuna e Podujevës me 633 km² sipërfaqe, është Komuna më e madhe në Republikën e Kosovës



Figura 3. Pozita gjeografike e Komunës

1 Plani Zhvillimor Komunal.

2 Jusuf Osmani: Vendbanimet e Kosovës, Besiana (Podujeva), Prishtinë, 2004.

1.3 KLIMA

Në Komunën e Podujevës temperatura mesatare është 9,6 oC, muaji me i ftohtë është janari me temperaturë mesatare -2,1oC, muaji më i ngrohtë është korriku dhe gushti me 20,1oC. Muaji më i ftohtë me temperaturë ekstreme është janari me -27,2 oC, ndërsa muaji me temperaturë më të lartë është gushti me 37,0oC. Amplituda më ekstreme për këtë periudhë është 64,2 oC. Në periudhën vegetative paraqiten temperatura negative që nganjëherë sjellin dëme në bujqësi.³

Sasia vjetore e reshjeve është 697 mm që është nën mesataren e Kosovës për këtë periudhë (784mm). Muaji më i lagësht është maji (77,5), ndërsa muaji më i thatë marsi me 42,3mm. Si shihet në tabelë gjatë periudhës vegetative bien gati 50 % e sasisë së reshjeve. Prej stinëve, vjeshta është më e lagështa, ndërsa vera është më e thatë me 147,9 mm. Nëse kalkulojmë sasinë e reshjeve me madhësinë e territorit të Komunës së Podujevës del se mesatarisht bien 432 mil m³ ujë. Kjo është vlerë mesatare dhe duhet pasur parasysh se pika monitoruese është në pjesën e ultë. Me që territori i kësaj Komune shtrihet në pjesë malore që kanë sasi të reshjeve më të lartë, atëherë sasia e reshjeve duhet të jetë më e madhe.

Mesatarisht me borë janë 26 ditë, ndërsa me mbulesë bore janë 48,4 ditë, ose një muaj e gjysmë. Pjesa më e madhe vitit është pa mbulesë bore. Muaji që ka ditë me mbulesë bore më së shumti është shkurti me 11,7 ditë. Shtresa maksimale e borës është mjaft e lartë edhe pse e rrallë, megjithatë ndodhë ngase shkakton një varg problemesh në jetën e përditshme. Në muajin janar trashësia maksimale e borës mund të jetë edhe 96 cm që jep sinjal të çartë se mund të paralizojë të gjitha aktivitetet.⁴

1.4 DEMOGRAFIA

Sipas vlerësimit të vitit 2003 kjo Komunë ka rreth 122179 banorë.⁵

Tabela 1. Numri i popullsisë sipas regjistrimeve

Vitet	Nr. i popullsisë
Regjistrimi 1948	43783
Regjistrimi 1953	48272
Regjistrimi 1961	53480
Regjistrimi 1971	62324
Regjistrimi 1981	77423
Vlerësimi 1991	94943
Vlerësimi 2003	122179

Popullsia e Komunës së Podujevës jeton në gjithsej 78 vendbanime, prej tyre 77 janë fshatra dhe vetë qyteti i Podujevës. Këto vendbanime kanë dallime të theksuara sa i përket numrit të popullsisë. Në qytetin e Podujevës jetojnë 43003 banorë, që do të thotë së rreth 35 % e popullsisë së tërësishme jeton në këtë qytet, ndërsa në të gjitha vendbanimet e tjera jetojnë rreth 79176 banorë apo rreth 65 %.

Dendësia e popullsisë në Komunën e Podujevës është rreth 194.3 banorë në 1 km², ku rreth 122179 banorë jetojnë në 628.7 km².

³ Dr. Ruzhdi Pllana: Trashëgimia Etnokulturore dhe Historike e Llapit, Prishtinë, 1995.

⁴ R. Pllana: Hidrologjia e lumit "Llap", Buletini i FSHMN, Prishtinë.

⁵ Vlerësimi i popullsisë në vitin 2003 – Komuna e Podujevës.

1.5 PASURITË NATYRORE

1.5.1 Mineralet

Komuna e Podujevës është e pasur me resurse të shumta minerare dhe prej tyre më të njohura janë mineralet që përdorën në industrinë e ndërtimit si: Silikatet (sh), Karbonatet (ch), Graveli (gs), Kley (cl), pastaj, Nikeli (Ni), Plumbi (Pb), Zinku (Zn) dhe Alumini (Al)⁶.

Sa i përket sasisë së këtyre rezervave nuk ekzistojnë të dhëna të sakta, kurse sa i përket shtrirjes së tyre mund të themi se pjesa dërrmuese e tyre shtrihet në anën jug-lindore dhe veri-perëndimore të Komunës së Podujevës. Sigurisht që investimet në sektorin e minierave janë të kushtueshme dhe mund të themi se Qeveria lokale as që mund të imagjinoj tash për tash eksploatimin e rezervave minerare në thellësi. Gjithashtu, edhe Qeveria qendrore ndodhet në të njëjtën gjendje financiare, kurse investorët mund të jenë të interesuar pasi të kenë informacione të sakta në lidhje me rezervat, si dhe atëherë kur kushtet tekniko-ligjore të jenë më të favorshme. Ndërsa, sa i përket resurseve minerare sipërfaqësore, disa prej tyre veç janë duke u shfrytëzuar nga kompanitë private vendore. Numri i gurthyesve në Komunën e Podujevës është dy (2), njëri ndodhet në Murgull dhe tjetri në Turuqicë.

1.5.2 Pyjet

Deri vonë Komuna e Podujevës është identifikuar si një prej Komunave me sipërfaqe të mëdha me pyje në nivel Kosove, ndërsa pas luftës, si pasojë e menaxhimit jo të mirë ka ardhur derti të një degradim dhe shkatërrim i madh të pyjeve. Përveç kësaj, bartja e kompetencave nga niveli qendror në atë lokal kufizon faktin lidhur me menaxhimin e pyjeve dhe rikuperimi i këtij sektori do të jetë një sfidë për të ardhmen.

Sipërfaqet me pyje të cilat shtrihet në Komunën e Podujevës janë gjithsej 29,050 ha, prej të cilave, nga:

- Sektori shoqëror 17.600 ha
- Sektori privat/individual 11.450 ha
- Gjithsej 29.050 ha

1.5.3 Tokat bujqësore

Komuna Podujevës përfaqësohet me tipa të llojllojshme të tokave: toka aluviale, deluviale, rendzinë, ranker, murme argjilore liqenore, e mesme e kuqërremtë, pseudogleje etj.

Tokat aluviale, si toka hidromorfike të cilësisë së lartë, shtrihen përgjatë lumit “Llap”, si dhe tokat të tjera që kanë cilësi të mira kultivimi, siç janë: deluviale, e mesme e kuqërremtë, rendzinat shtrihen, po ashtu, në fushëgropën e Llapit me trashësi mbi 25cm - b80> cm.

6 Mineral Map of Kosova 1:200.000; KPMO ose ICMO.

Tipi i llojeve të tjera të tokës kanë përhapje në tërë territorin e Komunës, si: rankere, psudoglej, murrme argjilore etj.

Tabela 2. Lloji i tokave dhe sipërfaqet

Lloji i tokës	Sipërfaqja/ha
Toka aluviale	5842 ha
Toka deluviale	2918 ha
Toka rendzinë	4804 ha
Toka ranker	5025 ha
Murrme argjilore e liqenore	23 ha
E mesme e kuqërremtë	4228 ha
Toka psudogleje	4030 ha

Boniteti i tokave. Sipërfaqet e tokave bujqësore sipas klasave të bonitetit

Klasa	Sipërfaqe /ha	%
Klasa I	1683	3
Klasa II	5613	9
Klasa III	3232	5
Klasa IV	4794	8
Klasa V	6522	10
Klasa VI	38090	60
Klasa VII	2936	5
Gjithsej	62870	100

Burimi: Në bazë të hartës së hidroekonomisë së Kosovës

Në bazë të dhënave 15322ha ose 25 % janë nën mbrojtje në bazë të ligjit të bujqësisë, ku kategoritë I-IV janë nën mbrojtje për përdorim për kultivim të kulturave të ndryshme bujqësore. Rreth $\frac{1}{4}$ e sipërfaqes së përgjithshme të Komunës ka vlera të larta të bonitetit, ato shtrihen kryesisht përgjatë fushëgropës së lumit “Llap”.

Boniteti i klasës V-VI-VII shtrihen në rreth 75 % të sipërfaqes së përgjithshme. Janë më pak kualitative për kultura bujqësore e sidomos ato të klasës VII.

1.5.4 Burimet ujore

Territori i Komunës së Podujevës ka një rrjet hidrografikë, i cili i drenon ujërat në drejtim të pellgut të Detit të Zi. Ujërat sipërfaqësor paraqiten në formë të përroskave, përrenjve burimeve dhe lumenjve. Nëpër këtë territor buron dhe shtrihet lumi “Llap”, i cili njëkohësisht është dega më e rëndësishme e lumit “Sitnica”. Lumi “Llap” buron nga malet e Albanikut. Mirëpo, si degë duhet të

merret lumi “Murgulla”⁷. Gjatësia e këtij lumi në Komunë është 61 km, ndërsa deri në grykëderdhje në lumin “Sitnica” 82,7 km. Gjatë reshjeve intensive dhe shkrirjes së borës gjatë stinës së dimrit, kur temperaturat rriten, lumi del nga shtrati dhe i përmbytë pjesët rreth tij, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme. Lumenj të tjerë janë: Lumi “Duminca”, “Batllava”, “Kaqandollit”.

Treva e Llapit është e pasur edhe me ujëra termo-minerale, si: Burimi mineral në fshatin Sallabaj dhe burimet termo-mineral në Shakovicë.




FIG. 4 UJËRAT TERMOMINERALE

1.6 EKONOMIA

1.6.1 Industria

Në Komunën e Podujevës ekzistojnë 311 ndërmarrje prodhuese të ndryshme, të gjitha këto ndërmarrje janë privat, kryesisht janë industri e lehtë. Ish-ndërmarrjet publike janë privatizuar. Prej ndërmarrjeve më të rëndësishme janë: Fabrika e Armaturës Ndërtimore “FAN”, Fabrika e tullave “Euro Bllok”, Ndërmarrja ricikluese “Plastika”, Fabrika për përpunimin e kërpuhave “Agro-Produkt”, Fabrika e lëngjeve “Dona”, Fabrika e lëngjeve dhe e vajit “Pajtimi Kompani” etj.

1.6.2 Bujqësia

Komuna e Podujevës ka fond të konsiderueshëm të tokës bujqësore. Rreth 55 % apo 34191.38 ha është tokë e punueshme, që e përbëjnë arat, kopshtet, kullosat, livadhet dhe tokat djerrin. Në strukturën e tokës së punueshme dominojnë arat, pastaj janë livadhet dhe kullosat, ndërsa sipërfaqet me pemishte, vreshta dhe kopshte janë më të vogla.

Sipërfaqja e tokës së punueshme sipas llojit të sipërfaqes bujqësore e shprehur në përqindje. Në sipërfaqen e përgjithshme të tokës bujqësore dominojnë arat me 18450.63 ha ose 54 %. Livadhet përfshijnë sipërfaqen prej 7594.75 ha ose 22 %. Gjithashtu, pjesëmarrje gati të njëjtë kanë edhe kullosat me 7361.27 ha ose 22 %. Me pemishte janë 705.53 ha ose 2 %, kurse vreshtat (15.92 ha) dhe kopshtet (63.28 ha) kanë një pjesëmarrje shumë të vogël me më pak se nga 1 %.

7 R. Pllana: Hidrologjia e lumit “Llap”, Buletini i FSHMN, Prishtinë, 1981.

Në kuadër të tokës së punueshme kultivohen lloje të ndryshme të kulturave bujqësore nga të cilat dominojnë drithërat, pastaj radhiten perimet dhe pemët. Prodhimtaria bujqësore është e mirë në përgjithësi, ndërsa drithërat kanë pjesëmarrje me 11,805 tonë ose 6 tonë/ha, gjë që është prodhimtari e kënaqshme, duke marr në konsideratë kualitetin e tokës dhe mundësit e tjera tekniko-teknologjike. Prodhimtaria në perimtari është 3.880 tonë ose 11 tonë/ha, ndërsa prodhimtaria në pemë është 757 tonë ose 5 tonë/ha.⁸

Krahas pjesëmarrjes më të madhe të sipërfaqeve me ara edhe prodhimtaria e drithërave është më e lartë, ndërsa prodhimtaria e perimeve dhe pemëve konsiderohet më e vogël. Ndër perimet të cilat kultivohen në sipërfaqe më të mëdha janë lakra, e cila merr pjesë me 30 %, pastaj janë qepët me 23 %, speci i gjelbër me 20 %, domatet me 15 %, kurse perimet e tjera, si lulëlakra, sallata dhe trangujt kanë pjesëmarrje më të vogël.⁹

Numri i madh i pronave që kanë sipërfaqe të vogël mbetet njëra ndër sfidat kryesore për zhvillimin e bujqësisë në Komunën e Podujevës.

Bujqësia, si sektorë shumë i rëndësishëm ekonomik, në Komunën e Podujevës përbën 4.12 % të bizneseve dhe 3.54 % të të punësuarve. Të dhënat me të cilat disponohet janë të dhënat mbi regjistrimin e bizneseve të vitit 2002 dhe 2009.

Blegtoria – Komuna e Podujevës ofron mundësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e blegtorisë. Pozita gjeografike, madhësia e territorit, lartësia mbidetare, peizazhet e jashtëzakonshme e bëjnë këtë veprimtari shumë atraktive dhe në rritje e sipër.

Gjendja e tanishme në sektorin e blegtorisë, sipas fermave dhe krerëve, është si në tabelën në vijim:

Tabela 4. Struktura e bagëtisë në Komunën e Podujevës

Nr.	Lloji i kafshës	Numri i fermave	Numri i krerëve
1	Lopë	374	3.740
2	Dele	70	4.500
2	Dhi	10	520

Burimi: Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Komuna e Podujevës

Në këtë numër nuk janë përfshirë ekonomit familjare, por vetëm fermat.

Bletaria – Një veprimtari shumë profitabile, në rritje dhe me mundësi dhe resurse të mëdha për tu zhvilluar dhe për të ndihmuar ekonominë familjare dhe më gjerë. Në territorin e Komunës së Podujevës kultivohen gjithsej rreth 3.782 shoqëri bletësh, në lokalitete të ndryshme.

Shepçetaria – Me këtë veprimtari në Komunën e Podujevës aktivisht merren tetë (8) ferma të cilat posedojnë rreth 75.000 krerë pula vojse.

Perimtaria – Një nga fushat ku kemi rritje të vazhdueshme të sipërfaqeve të mbjellura si në fushë të hapur po ashtu edhe në sera. Nga një veprimtari familjare është shndërruar në një veprimtari shumë profitabile.

⁸ Veglat e punës të plotësuar nga Komuna e Podujevës, tabela e ZHE, Bujqësia.

⁹ MBPZHR, Raporti i mbjelljeve pranverore, 2005.

Sipërfaqet e mbjellura:

Kultura - Sipërfaqja
 Perimet - 41.00 ha
 Serra - 39 ha

Tabela 5. Kulturat perimore që më së shumti mbillen

Lloji	Rendiment
Speci	25 - 30 ton/ha
Domatja	40 - 50 ton/ha
Lakra	50 - 55 ton/ha
Karota	20 ton/ha
Qepa	25 - 30 ton/ha
Sallata	15 ton/ha
Spinaqi	15 ton/ha
Tranguj	30 ton/ha
Purrini/preshi	30 ton/ha
Lule lakra	40 ton/ha
Hudhra	8 ton/ha

Burimi: Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Komuna e Podujevës

Pemëtaria – Kohët e fundit komuna e Podujevës ka shënuar rritje pozitive në ngritjen e plantacioneve të reja me pemë. Mundësit e shumta dhe kushtet e volitshme, si tokësore, po ashtu edhe klimatike, atëherë po kalohet nga pemëtaria ekstensive në atë intensive.

Tabela 6. Sipërfaqet e mbjellura sipas kulturave pemëtari/rendimenti

Kultura	Sipërfaqe	Rendiment
Mollë	6 ha	8,000 - 10,000 kg/ha
Dardhë	4 ha	10,000 kg/ha
Kumbull	25 ha	9,000 kg/ha
Dredhëz	1.8ha	3,000 kg/ha
Mjedër	4 ha	6,000 - 7,000 kg/ha

Burimi: Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Komuna e Podujevës

Lavërtaria – Tradicionalisht konsiderohet si sektori më i kultivuar në Komunën e Podujevës, mirëpo për shkak se nuk ka profit, si sektorë të tjerë, ka tendenca të zvogëlimit të sipërfaqeve të mbjellura me këto kultura.

Tabela 7. Sipërfaqet e mbjellura sipas kulturave lavërtarie/rendimentit

Lloji	Rendiment
Speci	25 - 30 ton/ha
Domatja	40 - 50 ton/ha
Lakra	50 - 55 ton/ha
Karota	20 ton/ha
Qepa	25 - 30 ton/ha
Sallata	15 ton/ha
Spinaqi	15 ton/ha
Tranguj	30 ton/ha
Purrini/preshi	30 ton/ha
Lule lakra	40 ton/ha
Hudhra	8 ton/ha

Burimi: Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Komuna e Podujevës

Pemëtaria – Kohët e fundit komuna e Podujevës ka shënuar rritje pozitive në ngritjen e plantacioneve të reja me pemë. Mundësit e shumta dhe kushtet e volitshme, si tokësore, po ashtu edhe klimatike, atëherë po kalohet nga pemëtaria ekstensive në atë intensive.

Tabela 6. Sipërfaqet e mbjellura sipas kulturave pemëtari/rendimenti

Kultura	Sipërfaqe	Rendiment
Mollë	6 ha	8,000 - 10,000 kg/ha
Dardhë	4 ha	10,000 kg/ha
Kumbull	25 ha	9,000 kg/ha
Dredhëz	1.8ha	3,000 kg/ha
Mjedër	4 ha	6,000 - 7,000 kg/ha

Burimi: Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Komuna e Podujevës

Lavërtaria – Tradicionalisht konsiderohet si sektori më i kultivuar në Komunën e Podujevës, mirëpo për shkak se nuk ka profit, si sektorë të tjerë, ka tendenca të zvogëlimit të sipërfaqeve të mbjellura me këto kultura.

Tabela 7. Sipërfaqet e mbjellura sipas kulturave lavërtarie/rendimentit

Drithëra	Sipërfaqe	Rendiment
Grurë	4,380 ha	5,000 kg/ha
Elb	22 ha	3,500 kg/ha
Thekër	112 ha	3,000 kg/ha
Misër	2,928 ha	6,500 kg/ha
Tërshërë	1,485 ha	3,500 kg/ha
Patatja	1,936 ha	50,000 kg/ha
Bimë foragjere	Sipërfaqe	Rendiment
Sanë	3,200 ha	6,000 kg/ha
Jonxhë	2,800 ha	6,500 kg/ha

Burimi: Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Komuna e Podujevës

1.6.3 Energjia elektrike

Pozita gjeografike e Komunës i mundëson një rrjet të rëndësishëm të furnizimit me energji elektrike. Përveç linjave të furnizimit me energji elektrike me kapacitet 35kv, të cilat vijnë nga drejtimi i Prishtinës (Obiliq – Mazgit – Koliq – Podujevë), në territorin e Komunës kalojnë edhe linjat transite të tensionit të lartë - Internacional (Prishtinë – Podujevë – Krushevc 220KV) dhe Obiliq (“Kosova B” – Nish me kapacitet 400KV).

Furnizimi i qytetarëve të Podujevës me energji elektrike bëhet nëpërmjet të linjës së Prishtinës me kapacitet prej 220KV (“Kosova B” – Podujevë) deri tek trafo-stacionit kryesor, i cili gjendet në Komunë të Podujevës dhe ka gjatësi prej 30.67 km dhe linja Mazgit – Podujevë 35KV me gjatësi prej 25.88 km.

1.6.4 Turizmi dhe hoteleria

Komuna e Podujevës karakterizohet me potenciale të shumta të zhvillimit të turizmit vikendor dhe rural. Gjeomorfologjia e territorit të Komunës së Podujevës e karakterizuar me dy masive malore, “Albanikun” dhe “Gollakun”, si dhe fushëgropa e “Llapit” së bashku me lumin e “Llapit” dhe liqenin e “Batllavës” i japin vlerë konkurruese Komunës së Podujevës në Kosovë. Liqeni i “Batllavës”, i cili furnizon me ujë të pijes katër Komuna, si: Podujevën, Prishtinën, Fushë-Kosovën dhe Obiliqin, njëkohësisht ofron kushte të mira për turizëm .Gjatë sezonit verorë ky liqen tërheq mijëra vizitorë të cilët vijnë për pushime në hapësirat përgjatë tij, ku në shumicën e rasteve manifestohet edhe me krijimin e problemeve të caktuara mjedisore.



Figura 5. Liqeni i Batllavës¹⁰

Gjithashtu, edhe hoteleria është mjaft e zhvilluar, ku në Komunën e Podujevës janë rreth 280 biznese hoteliere me rreth 700 të punësuar. Pjesëmarrja e hotelerisë ndaj numrit të bizneseve dhe punëtorëve të regjistruar gjithsej në Komunën e Podujevës është rreth 9.10 %. Ndërsa, shtrirja e bizneseve hoteliere është e shprehur kryesisht përgjatë rrugëve të karakterit nacional (magjistrale – regjionale), rrugëve të asfaltuara, si dhe objekteve dhe peizazheve të tjera me atraktivitet të veçuar. Vetëm në qytetin e Podujevës janë të përqendruara rreth 90 % e bizneseve hoteliere, kurse pjesa tjetër ose 10 % në vendbanimet e tjera.

Rëndësi dhe vlera të tjera turistike në Komunën e Podujevës janë edhe objektet ose monumentet e trashëgimisë kulturore, të cilat janë të krijuara në periudha të ndryshme historike. Gjithashtu, vlerësohet edhe trashëgimia më e re që ka vlerë të veçantë, si: Kulla e dëshmorit të kombi Zahir Pajaziti, si dhe shumë lapidarë të të rënëve për çlirimin e Kosovës, të cilat monumente e pasqyrojnë ofertën turistike në këtë Komunë.



Figura 6. Kulla e dëshmorit të kombit Zahir Pajaziti

¹⁰ www.panoramia.com

1. 6. 5 Biznesi privat

Sektori privat – Sipas shënimeve nga Zyra e Bizneseve, në Komunën e Podujevës janë të regjistruara 3,122 biznese.

Struktura e bizneseve vazhdon të jetë jo e favorshme për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Komunës, pasi shumica prej tyre janë tregtare ose 46.22 %. Fillimi i ndryshimit të kësaj strukture në favor të atyre prodhuese do të jetë një nga prioritetet e Komunës.

Tabela 8. Struktura e bizneseve private

	Veprimtaria e bizneseve	Nr. i bizneseve	Nr. i punëtorëve
1	Tregtare	1,505	3,702
2	Prodhuese	311	956
3	Shërbyese	798	1909
4	Të tjera	508	1,416
5	Total	3,122	7,983

Burimi: Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, Komuna - Podujevë

Nëse analizohet struktura e bizneseve në Komunën e Podujevës atëherë do të konstatojmë se afro gjysma e tyre apo saktësisht 46.22 % i përkasin sektorit të tregtisë dhe pastaj vjen me radhë industria me 13.42 %, transporti me 9.19 %, hoteleria me 9.10 %, shërbimet 6.44 % dhe 15.63 % të tjera.

1.7 INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET PUBLIKE

1. 7. 1 Ujësjetësi dhe kanalizimi

Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm

Furnizimi me ujë të pijshëm në mënyrë të organizuar në Komunën e Podujevës daton që nga vitet '50-ta. Nga ky sistem furnizohej vetëm qyteti i Podujevës. Sot Komuna e Podujevës furnizohen me ujë nga dy drejtime:

- Nga fabrika e ujit në Shajkovc dhe;
- Nga sistemet e pompimit nga pusët e Peranit

Sistemi i ujësjetësit qendrorë të Podujevës menaxhohet nga KUR "Prishtina" njësia operative e ujësjetësit në Podujevë. Ujësjetësi aktualisht disponon me 100 litra/sec dhe atë 80 l/sec nga akumulacioni në Batllavë dhe 20 l/sec të ujit nëntokësor nga pusët e Peranit. Nga ky sistem furnizohen 87370 banorë ose 71.51 % të popullatës së Komunës. Në bazë të sasisë të ujit, që momentalisht janë në dispozicion, konsumimi mesatar ditorë për banorë, vlerësohet të jetë përafërsisht 90-100 litra në ditë. Në proporcion me rritjen e numrit të banorëve për 10 vjetet e ardhshme, nevoja për sasi të ujit të pijshëm do të jetë 265 litra/sec.

Pjesa e banorëve 28.49 % apo 10853 banorë nuk furnizohet me ujë të pijshëm nga sistemi qendror, por nga sistemet e vogla lokale dhe puse individuale. Cilësia e këtyre ujërave është jo e sigurt, rezultatet flasin për nivel të lartë të kontaminimit, 65 % janë ujëra jo të pijshëm. E tëra kjo është për arsye të mungesës së dezinfektimit dhe menaxhimit të këtyre resurseve. Kjo situatë e rëndon dukshëm standardin jetësor të banorëve të kësaj zone.

Rrjeti i kanalizimit

Funksionimi i kanalizimit të ujërave të ndotura në komunën e Podujevës është ndërtuar në vitet 1950 – 1970 se bashku me instalimin e ujësjellësit për qendrën e qytetit. Sistemi i kanalizimit i ujërave fekale është i shtrirë në 38 rrugë me gjatësi të rrjetit përmblendhës 39 km. Vlerësohet se aktualisht rreth 50% e rrjetit është i amortizuar.

Viteve të fundit vërehen investime të mëdha nga komuna në sistemin e kanalizimit. Pjesa më e madhe e ujërave të zeza të kanalizimeve derdhen pa asnjë trajtim paraprak në shtratin e lumit Llap në lokacionin te lagja Polonicë që ndodhet në jug të qytetit.

Sistemi i kanalizimit të ujërave fekale tani është në menaxhim të KUR “Prishtina” njësisë operative në Podujevë dhe ofron shërbime në:

- Qytetin e Podujevës me lagjet për rreth dhe në fshatrat të cilat janë të kyçur në sistemin e ujësjellësit.

Shfrytëzues të këtij shërbimi janë përafërsisht 55000 banorë ose rreth 45 % të popullsisë së përgjithshme të Komunës. Nga të dhënat e njësisë operative të ujësjellësit në Podujevë, raportohet se numri i konsumatorëve të mbuluar me shërbime të kanalizimit dhe të ujësjellësit është i njëjtë dhe sipas faturimit për vitin 2011 raportohet:

1. Amvisëri – zona urbane – 100 % kyçje, - 60 % inkasim;
2. Institucione – zona urbane – 100 % kyçje, - 100% inkasim dhe;
3. Biznese – zona urbane – 100 % kyçje, - 70% inkasim

Sistemet e kanalizimit në vendbanimet Zakut dhe Shakovicë është vetanak, të ndërtuar në sistem të pastruesit biologjik vertikal, të mbuluar me shevar-bari i kënetës. Pjesa e popullatës të Komunës që nuk kanë qasje në rrjetin e kanalizimit kolektiv, ujërat e zeza i derdhen në mënyrë të egër në lokacione të ndryshme në shtratin e përroskave dhe lumenjve të vendbanimeve ku jetojnë. Popullata e këtyre vendbanimeve paraqet rreth 55 % të popullatës së përgjithshme në Komunë.

Të gjitha ujërat e këtyre sistemeve të kanalizimit, kryesisht jo të trajtuara, shkarkohen në rrjedhat e lumenjve “Llap”, “Dumnica”, “Batlava”, “Kaqandolli”, dhe shkarkojnë ndotje të lumit, tokës dhe sigurisht edhe ujërave nëntokësor. Një ndotje e tillë paraqet kërcënim seriozë për shëndetin e popullatës dhe për mjedisin në tërësi.¹¹

Sistemi i rrjetit të kanalizimit të ujërave atmosferike është në mbikëqyrje të ndërmarrjes për menaxhim të mbeturinave. Rrjeti përmblendhës i ujërave atmosferike në qytet është i shpërndarë në gjatësi prej 20-25 km me kapacitet Ø 200 mm - Ø 400mm, me puseta të vendosura në largësi 40-50 m për gjatë rrugëve të qytetit. Këto puseta janë të vjetruara dhe të dëmtuara dhe mirëmbajtja e tyre është e vështirësuar. Pjesa më e madhe e rrjetit të kanalizimit të ujërave atmosferike janë të rehabilituara me ndërtimin e rrugëve pas vitit 2000. Ujërat atmosferike derdhen në lokacionin të ndryshme përgjatë rrjedhjes së lumit “Llap”.¹²

1.7.2 Menaxhimi i mbeturinave

Në Komunën e Podujevës menaxhimin dhe shërbimin e grumbullimit, bartjen dhe deponimin e mbeturinave e kryen KRM “Pastrimi”, shoqëria aksionare - Prishtinë, njësia operative në Podujevë.

¹¹ Raporti i ujësjellësit – Podujevë, 2008/2009.

¹² Ndërmarrja për menaxhim të mbeturinave “Pastrimi” – Podujevë, 2012.

Në këtë ndërmarrje janë të punësuar 36 punëtorë të cilët merren me grumbullimin, bartjen dhe deponimin e mbeturinave të ngurta nga amvisnit dhe industria.

Kjo kompani i kryen shërbimet në qytetin e Podujevës dhe në disa fshatra, si në Sekirag, Lluzhan, Shakovicë, Sallabajë, si dhe nga një pjesë të fshatrave Peran, Surkish dhe Llugë. Veprimtaria e tyre mund të shtrihet edhe në vendbanime të tjera me kërkesat e banorëve. Në bazë të analizave ky shërbim është ende në shkallë të ultë, ngase vetëm 35-40 % të popullatës në Komunë janë të mbuluara me këto shërbim. Nga gjendja reale e paraqitur në bazë të faturimit kjo njësi ofron shërbim për:

- 630 objekte biznesi nga të cilët faturimi i realizuar është nga 35- 40 %;
- 3200 amvisni , ku shkalla e inkasimit sjellët 50-55 % dhe;
- 30 shërbime me kontrata të veçanta për biznes, institucionet shoqërore (shëndetësi, banka, shkolla, komuna, institucionet fetare etj.), realizimi i faturave është 100 % të kontratës.

Në territorin ku vepron kjo ndërmarrje mbeturinave mblidhen në sistem derë në derë. Gjithashtu, janë të shpërndarë 50 kontejnerë 1.1m³ dhe 4 kontejnerë të mëdhenj 7 m³ të vendosur në lokacionin e tregut dhe institucionet-prodhimtarit me kontratë të veçantë. Sasia e mbeturinave të grumbulluara bartet në lokacionin e deponisë në Dumnicë, e ndërtuar nga AER në vitin 2005. Kjo deponi nuk i përmbush standardet meqë paraprakisht nuk ka klasifikim ose ndarje të mbeturinave, hedhurinat e lëngëta dhe ujërat nga deponia nuk mblidhen dhe nuk trajtohen, gazrat nga deponia lëshohen në mënyrë të pakontrolluar etj. Si e tillë kjo deponi paraqet rrezik permanent për ndotje të mjedisit dhe rrezikon shëndetin e banorëve të Komunës.

Në vendbanimet rurale të Komunës ekzistojnë shumë deponi të egra, shpesh herë nga 2-3 sosh në çdo vendbanim. Nga këto deponi ilegale, edhe pse nuk janë në mbikëqyrje të kompanisë, shpesh herë me iniciativë të Komunës bëhet grumbullimi i tyre dhe bartja në deponin qendrore ku çmimi për një ton është 6 €.

Pos menaxhimit dhe organizimit të mbeturinave, kompania bënë edhe pastrimin e rrugëve, Me kontratë të veçantë bënë mirëmbajtjen e gjelbërimit (ujitjen, kositjen, plehërimin e barit, si dhe prashitjen e luleve) dhe mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit të ujërave atmosferik. Ky rrjetë i gjatë 20-25 km është i shtrirë në zonën urbane dhe disa para lagje. Gjatë sezonit veror rrugët pastrohen çdo ditë në orët e natës. Uji për këtë qëllim merret nga pusi i KUR “Prishtina”, i cili ndodhet në vendbanimin Peran. Mirëpo, duhet të bëhet hapja e pusit të ri në lokacionin e ri të kompanisë.

1.7.3 INFRASTRUKTURA RRUGORE DHE TRANSPORTI PUBLIK

Infrastruktura rrugore

Në Komunën e Podujevës janë numër i madh i rrugëve të cilat ndahen sipas kategorive:

Tabela 9. Rrjeti i rrugëve sipas kategorisë

Nr.	Përshkrimi	Gjatësia total në km
1	Rrugë magjistrale	18.8
2	Rrugë regjionale	80
3	Rrugë lokale	370.1
4	Rrugë e pa kategorizuar	756.3
Total	1225	




Figura 7. Koncepti i zhvillimit të infrastrukturës rrugore

Rrjeti hekurudhor

Rrjeti hekurudhor në Komunën e Podujevës është i karakterit nacional dhe ka shtrirje në pjesën qendrore të Komunës së Podujevës, përkatësisht i takon kategorisë së komunikacionit magjstral, i cili i lidhë dy shtete fqinjë (Republikën e Kosovës dhe Serbinë). Kjo linjë hekurudhore kalon në pjesën qendrore të Komunës së Podujevës dhe është një binarësh, me gjatësi prej 22 km.

Transporti publik

Në nivel lokal organizohet nëpërmjet të autobusëve, kombi-busëve, auto-taksive dhe është mjaft mirë i organizuar. Shikuar nga numri i vendbanimeve që kanë transport publik, nga 78 vendbanime sa ka Komuna e Podujevës, 40 prej tyre kanë qasje në transport publik nëpërmjet të autobusëve, 21 nëpërmjet të kombi-busëve dhe 17 vendbanime nuk kanë transport publik.¹³

13 Të dhënat janë nga Kuvendi Komunal i Podujevës.

1.7.4 Ndriçimi publik

Ndriçimi publik është evident vetëm në zonën urbane të Komunës dhe ka gjatësi prej 4,150 metra. Rrjeti i sistemit të ndriçimit është i përbërë prej 383 shtyllave, prej tyre metalike 80, ndërsa shtylla të drurit 303, më se 90 % është ndriçim eficient.¹⁴

1.7.5 Shërbimet e telekomunikimit dhe mediat

Telefonia fikse-Rrjeti i telefonisë fikse në Komunën e Podujevës është i lidhur nëpërmjet fibrës optik, i cili i përket linjës së trasesë Prishtinë – Podujevë. Ky rrjet menaxhohet nga njësia e PTK-së, në Podujevë, e cila posedon centralin e lidhur me fibrin optik dhe ka kapacitet total 7200 qifte. Momentalisht, shfrytëzohen 1771 qifte. Shtrirja e rrjetës së telefonisë fikse ekzistuese mundëson qasje të mbi 46.8 % të popullsisë në rrjetin e telefonisë fikse.

Telefonia mobile-Në territorin e Podujevës është e mbuluar mjaftë mirë. Pothuajse të gjitha vendbanimet e Podujevës kanë qasje në shërbimet e telefonisë mobile, të cilat ofrohen nga dy operatorët e licencuar nga ART-ja. Të dy operatorët mobil kanë të shpërndara antena individuale në lokacione të ndryshme të Komunës, mirëpo duhet të bëhet koncentrimi i antenave në një ose dy lokacione të caktuara në bashkëpunim me operatorët e telefonisë mobile.

Shërbimet postare

Duhet të vazhdohet shpërndarja e shërbimeve postare në sistemin aktual të shpërndarjes

Shërbimet e internetit

Bashkëpunimi i ngushtë me operatorët e telefonisë mobile për stimulimin e qytetareve të Podujevës në shfrytëzimin e mundësive për përdorim të internetit në nivel të vendbanimeve.

Radiotelevizioni

Në Komunën janë dy radio lokale, nuk ka televizion lokal.

1. 8 SHËRBIMET SOCIALE

1. 8.1 Arsimi

Nga gjithsej 66 objekte shkollore, ujë të pijshëm kanë 55 objekte shkollore, kurse 11 prej tyre kanë furnizim të pjesërisht. Në sistemin e kanalizimit kanë kyçje vetëm 39 objekte shkollore, kurse 27 prej tyre kanë gropat septike, që paraqesin një zgjidhje jo të mirë, si për shkollën, ashtu edhe për komunitetin që jeton afër shkollave.

Nga 66 objekte të institucioneve arsimore në Komunë 41 e sigurojnë ngrohjen me lëndë djegëse (dru), 15 prej tyre dru dhe thëngjill (ngrohje qendrore) dhe 10 prej tyre e shfrytëzojnë naftën si lëndë djegëse për ngrohje.¹⁵

¹⁴ Të dhënat janë nga Kuvendi Komunal i Podujevës - Zyra për Shërbime Publike.

¹⁵ Të dhënat nga Drejtoria Komunale për Arsim – Podujevë, Raporti i vitit 2007-2008, Raporti i vitit 2009-2010 dhe Formulari i përgatitur nga ana e Drejtoratit të Arsimit për Bankën Botërore).

Numri i nxënësve nëpër nivele dhe paralele - Duke marrë parasysh që me ligj, arsimi para-fillor është bërë i obligueshëm është shtuar nevoja për përfshirjen e të gjithë fëmijëve në këtë nivel dhe së këndejmi është shtuar edhe nevoja për hapësirë shtesë shkollore, por edhe për buxhet. Gjendja ekzistuese në këtë nivel të edukimit është jo e kënaqshme dhe vetëm 1,364 nxënës janë të përfshirë në këtë nivel të edukimit, kurse kërkesat për regjistrim në klasën e parë, në vitin shkollor 2010/2011, ishin deri në 3,800 nxënës.

- Numri i nxënësve në nivelin 0 (niveli parashkollor) 1,364;
- Numri i nxënësve në nivelin I (niveli fillor kl. I-V) 15,256;
- Numri i nxënësve në nivelin II (shkollë e mesme të ultë kl. VI-IX) 6,786 dhe;
- Numri i nxënësve në nivelin III (shkollë e mesme të lartë kl. X-XII/XII) 5,346 prej tyre janë në gjimnaz 1,910, kurse në dy shkollat e mesme të larta profesionale 3,436.

Vlen të theksohet fakti se, në Komunë nuk funksionon asnjë shkollë private.

1.8.2 Shëndetësia

Sipas ligjeve në fuqi, komunat janë kompetente për ofrimin e kujdesit primar shëndetësor. Komuna e Podujevës ka një gjendje relativisht të mirë të objekteve shëndetësore. Objektet shëndetësore të cilat funksionojnë në Komunën e Podujevës janë: 1 QKMF (Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare), 14 QMF (Qendra të Mjekësisë Familjare) dhe 7 Ambulanca.¹⁶

Shërbime parësore të fushave të specializuara mjekësore ofron gjithashtu edhe sektori privat. Vlen të përmendet se koncentrimi i sektorit privat është kryesisht afër Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në qytet.

Mirëqenia Sociale - Komuna e Podujevës është në mesin e komunave të mëdha të Kosovës dhe kjo si për kah sipërfaqja, po ashtu edhe për nga numri i banorëve. Megjithatë, u takon komunave jo mjaft të zhvilluara, prandaj edhe gjendja sociale-ekonomike është bukur e rënduar. Me qëllim që të ndikohet në zbutjen e problemeve socio-ekonomike, Komuna ka përgatit plane dhe strategjitë afat-shkurtër (2011-2014) dhe afatgjatë (2010-2020), kështu që ky planifikim po i jep rezultatet e veta.

Gjithsesi ballafaqimet e Komunës me kategoritë sociale janë si nga aspekti shëndetësor, ushqimor dhe të banimit. Në mënyrë intervente brenda mundësive buxhetore intervenohet me miell, herë-herë me lëndë djegëse, me pako ushqimore, higjienike etj.

Prej vitit 2009 e deri më tani për çdo vit Komuna për familjet të cilat nuk e kanë të zgjedhur problemin e strehim-banimit, nga mjetet vetanake ndërton nga 10 shtëpi individuale. Vlen të përmendet se për çdo vit është arritur që me donatorë të ndërtohen nga 4-5 shtëpi.

Numri i kategorive sociale në evidencën e DSHMS-së sillet rreth 1300 familje, ndërsa me asistencës sociale në QPS janë, kategoria e I- rë 747, ndërsa kategoria e II-të 433, gjithsej 1.180 familje. Jemi të vetëdijshëm se është bukur vështirë të përballohen ballafaqimet socio-ekonomike, por bëhet përpjekje që sado-kudo të zbutet ky problem.

¹⁶ Raporti vjetor QKMF – Podujevë, 2011.

1.8.3 KULTURA, RINIA DHE SPORTI

KULTURA

Llapjanët kanë treguar gjithmonë një interes të madh për të kontribuar në art dhe kulturë. Kultura tregon të kaluarën dhe të tashmen e një populli. Në Komunën e Podujevës zhvillimet kulturore kanë zënë vend që një kohë të gjatë. Në teatrin e qytetit kanë dalë shumë herë shfaqje e drama, që kanë bërë jehon të madhe jo vetëm në qytetit e Podujevës, por edhe në nivel vendi. Shumë artistë, këngëtarë dhe figura politike kanë origjinë nga Llapi. Të gjitha aktivitetet kulturore-sportive zhvillohen dhe organizohen në: Sallën e Kulturës, Palestrën Sportive, Stadiumin e Qytetit, Bibliotekën e Qytetit, e në raste të veçanta shfrytëzohen edhe objektet shkollore dhe disa aktivitete mbahen edhe në ambient të hapur.

RINIA

Rreth 65 % e popullsisë së përgjithshme e përfaqëson rinia, nën moshën 30 vjeç. Në këtë Komunë mund të thuhet se kushtet për zhvillimin e aktiviteteve rinore janë relativisht të mira. Aktivitetet rinore zhvillohen në shtëpinë e kulturës, palestrën sportive, bibliotekën e qytetit, qendrën rinore të qytetit, stadiumin e qytetit, fushat e vogla sportive (të mbuluara), në objekte shkollore etj. Mandej, themelimi i shumë organizatave rinore, qëllimi i të cilave është organizimi i aktiviteteve të ndryshme rinore etj.

SPORTI

Në këtë Komunë ekzistojnë një numër i madh i klubeve sportive, si: KF "Llapi", KF "Hysi" KFF "Llapi", KH "Llapi", KK "Llapi", KK "Besa", Ping Pongu "Llapi", KA "Llapi", KN "Orlani", Klubi "Kroni Fitnes", Klubi i Aeuronatikes "Llapi".

Në Podujevë ekzistojnë këto shkolla të futbollit: "Llapi", "Hysi", "Besiana", "Besa" dhe "Drita". Në Podujevë janë dy stadione të futbollit: stadiumi i KF "Llapi" dhe stadiumi i KF "Hysi".

Pjesa dërmuese e këtyre klubeve garojnë në nivele lokale, regjionale dhe nacionale.

1. 8. 4 Trashëgimia kulturore dhe historike

Trashëgimia kulturore e kësaj ane përmban një pasuri të madhe vlerash shpirtërore e materiale, me ngjarje e shkatërrime tragjike edhe të këtyre vlerave që nga antika e deri sot. Sipas të dhënave dhe zbulimeve historike e arkeologjike edhe Komuna e Podujevës, pjesë e Dardanisë antike, është tejet e pasur me vlera materiale autoktone. Zbulime arkeologjike janë gjetur në shumë vendbanime të kësaj treve që datojnë nga shekulli i II-të e.s. Duhet theksuar se shumë monumente antike mendohet se janë zhdukur plotësisht dhe në të shumtën e rasteve dalin vetëm në toponiminë e kësaj treve, ndërkohë që objektet e vjetra, për arsye të rrethanave historike, në pamundësi të kujdesit institucional, vazhdojnë të humbin gjurmët ose të dëmtohen shumë.

Qendër e rëndësishme e Dardanisë në kohën romake ishte Vendenisi (Gllamniku i sotëm). Këto mbetje arkeologjike janë prezentë në shumë vendbanime të Komunës, por ato që kanë mbetje më të theksuar dhe që sot ende ekzistojnë janë në: Gllamnik, Surkish, Popovë, Balloc etj.

Monumentet arkeologjike të rëndësisë lokale, nacionale dhe internacionale është - Sarkogfagu i gjetur në Gllamnik, me rëndësi nacionale. Ky sarkofag është i vendosur në muzeun e Kosovës në Prishtinë.

Monumentet arkitekturale të rëndësisë lokale dhe nacionale janë: Dy kullat në Herticë, ajo e Sali Agës dhe e Ajet Muçollit , Kulla e Zahir Pajazitit, Kompleksi në Reçicë, Përmendorja të Tabet e Llapashicës, Shtëpia Muze e Hasan Ramadanit , Kulla dhe oda e Dem Ahmetit kanë rëndësi nacionale.

Numri i monumenteve në këtë Komunë, sipas të dhënave të Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës dhe të dhënave plotësuese nga institucionet komunale, janë rreth 60 monumente.

Pjesa 3

II. GJENDJA E MJEDISIT

2. 1 MENAXHIMI I AJRIT

2. 1. 1 Emisionet e stacionuara

Në bazë të vlerësimeve të organeve kompetente komunale për kontrollimin e ndotjes së ambientit ndikim në ndotjen e ajrit kanë ndërmarrjet prodhuese për shkak të djegies së mazutit, thëngjillit dhe lendeve të tjera djegëse.

2.1.2 Emisionet e lëvizshme

Njëri ndër problemet kryesore që paraqitet si pasojë e ndotjes nga transporti është emisioni i lartë i gazrave nga lëndët djegëse të automjeteve, si: CO₂, NO_x, SO₂, CO. Emisionet nga automjetet shkaktojnë pjesën më të madhe të ndotjes me metalet e rënda si: Pb etj. Koncentrimi më i madh i kësaj ndotje nga qarkullimi i automjeteve është përgjatë rrugës kryesore Prishtinë-Podujevë-Merdare.

Në bazë të këtyre rezultateve, shihet se ekziston emision i gazrave të CO₂. Si pasojë e erërave që lëvizin në drejtim të Komunës së Podujevës ndikim ka edhe Korporata Energjetike e Kosovës, ku ndikimet në ndotjen e ajrit ujit dhe tokës vërehen në jugperëndim të Komunës, si në Lupq të Poshtëm e më tutje.

2.1.3 Cilësia e ajrit

Stacione matëse nuk ka në këtë regjion, prandaj mungesa e të dhënave ka ndikuar në një përshkrim të gjendjes të tillë. Në hapësirat ku objekte banimi janë shtëpitë individuale dhe ngrohja është individuale, emetimi i tymit është i lartë dhe në sezonin e dimrit kur shoqërohet me mjegull është tejet i rrezikshëm, ngase në situata të tilla nuk ka erë që do ta shpërndante.¹⁷

2.1.4 Identifikimi i problemeve dhe rekomandimet

Tabela 10. Identifikimi i problemeve – ajri

Fusha	Objekti	Synimi / Targeti	Treguesi/Indikacioni	Aktiviteti/Veprimi	Forma e zbatimit
Ajri	Përmirësimi i cilësisë së ajrit. Ulja e lirimit të gazrave ndotëse nga automjetet. Vendorsja e katalizatorëve në vetura.	Monitorimi i ajrit. Shkalla e ndotjes së ajrit brenda standardëve.	Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së ajrit. Ajri i pastër.	Vendorsja e stacioneve matëse për monitorimin e ajrit. Vendorsja e filtrave në fabrikat që lirojnë ndotje. Vendorsja e katalizatorëve në automjete.	Sigurimi i buxhetit. Hartimi i projektit detal. Zbatimi i ligjeve. Kostoja e projektit.

2.2 MENAXHIMI I UJIT

2.2.1 Furnizimi me ujë të pijshëm

Gjendja ekzistuese vlerësohet të jetë e deri diku e kënaqshme me tendencë në përmirësim, sistemi i vjetër i furnizimit me ujë është i ndërtuar para 40 vjetësh, por herë pas here po riparohet dhe zgjerohet me lloje të materialeve sipas standardeve që sot janë aktuale në vend dhe regjion.

Aktualisht KUR “Prishtina” sh.a NJO – Podujevë, e cila është ofruesi kryesorë i shërbimeve me ujë të pijshëm në Komunën e Podujevë, e cila ka këto të dhëna mbi përfshirjen e zonës së shërbimit;

Ujësjellësi aktualisht disponon me 100 litra/sec dhe atë 80 l/sec nga akumulacioni në Batëllavë dhe 20 l/sec të uji nëntokësor nga pusët e Peranit. Nga ky sistem furnizohen 87370 banorë ose 71.51 % të popullatës së Komunës. Në bazë të sasisë të ujit, që momentalisht janë në dispozicion, konsumimi mesatar ditorë për banorë, vlerësohet të jetë përafërsisht 90-100 litra në ditë.

¹⁷ Të dhënat nga Plani Zhvillimor Komunal .

2.2.2 Cilësia e ujit të pijshëm dhe monitorimi

Uji i ofruar për zonën e shërbimit të cilën e mbulon kjo njësi operative i plotëson standardet e ujit të pijshëm sipas rregullores, respektivisht standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) dhe rregulloreve dhe normave të IKSH. Metoda e pastrimit, trajtimit - përpunimit të ujit është vetëm me sistemin e klorifikimit në stacionet e klorimit.

Ku 10853 banorë ose 28,49 % e banorëve nuk furnizohet me ujë të pijshëm nga sistemi qendror, por nga sistemet e vogla lokale dhe puse individuale. Cilësia e këtyre ujërave është jo e sigurt, rezultatet flasin për nivel të lartë të kontaminimit. E tëra kjo është për arsye të mungesës së dezinfektimit dhe menaxhimit të këtyre resurseve. Kjo situatë e rëndon dukshëm standardin jetësor të banorëve të kësaj zone.

2.2.3 Kërkesa për ujë të pijshëm

Në proporcion me rritjen e numrit të banorëve për 10 vjetet e ardhshme, nevoja për sasi të ujit të pijshëm do të jetë 265 litra/sec, të cilat aktualisht janë 100 l/s.

2.2.4 Potencialet për zgjerim kapacitetesh për ujë të pijshëm

Kapacitete të reja për furnizim me ujë të pijshëm janë disa burime, si Vrellat e Revuqit, Dobratinit, si dhe ujërat nëntokësore, si në fshatin Peran etj.

2.2.5 Menaxhimi i ujërave të ndotura (Urbane dhe industriale)

Gjatësia e përgjithshme e rrjetit të kanalizimit fekal është mbi 120 km.

Pjesa më e madhe e ujërave të zeza të kanalizimeve derdhen pa asnjë trajtim paraprak në shtratin e lumit “Llap” në lokacionin të lagja Polonicë, që ndodhet në jug të qytetit.

Sistemi i kanalizimit të ujërave fekale tani është në menaxhim të njësisë operative të ujësjellësit dhe ofron shërbime në qytetin e Podujevës me lagjet përreth dhe në fshatrat të cilat posedojnë rrjetin e ujësjellësit




Figura 8. Harta e shtrirjes së rrjetit të kanalizimit në teritorin e Komunes

Menaxhimi i ujërave të ndotura- rekomandimet

Tabela 11. Identifikimi i problemeve – ujërat e zeza

Fusha	Objektivi	Synimi/Targeti	Treguesi/Indikacioni	Aktiviteti/Veprimi	Forma e zbatimit
Ujërat e zeza.	Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit nga 55% në 80 % dhe trajtimi i ujërave të zeza.	Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit për 25 % për 5 vitet në vazhdim. Trajtimi i ujërave të zeza në 80 % për vitet e ardhshme.	78 km gjatësi e rrjetit të kanalizimit. Niveli i kënaqshëm i banorëve. Përmirësim i mjedisit dhe shëndetit.	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit. Ndërtimi i impiantit për pastrimin e ujërave të zeza. Mirëmbajtja. Eliminimi i pikave të zbrazjeve të ujërave të zeza në lumenj.	Sigurimi i buxhetit. Hartimi i projektit detal. Pjesëmarrja e komunitetit dhe donatorëve. Kostoja e projektit.

2.2.6 Cilësia e ujit të lumenjve dhe shkalla e ndotjes

Si në tërë territorin e Kosovës edhe në Komunën e Podujevës ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë janë pambrojtje adekuat nga ndotja. Përdorimi i ujit në industri dhe amvisëri kthehet në shtratin e lumit i pa trajtuar që ka për pasojë ndërrimin e parametrave fiziko-kimik dhe biologjik të ujit. Shkarkimi i ujërave të zeza prej amvisërisë, bizneseve dhe industrisë, jo vetëm në këtë Komunë po bëhet problem serioz. Teknologjia e shtrenjtë për trajtim të ujërave të zeza ka ndikuar që edhe me këto pakë veprimtari industriale e biznese të tjera të kemi probleme serioze në degradimin e natyrës e sidomos të ujërave.

Të gjitha familjet me sasi të ndryshme përdorin mjete për mirëmbajtjen e higjienës (acide, sapun, shampun etj.), për amvisëri dhe shkarkimi i tyre është i drejtpërdrejt në lumenj. Burim potencial i ndotjes së ujërave janë edhe derdhja e vajrave motorike të përdorura që në mënyrë direkte apo indirekte ndotin ujërat sipërfaqësorë apo nëntokësorë.

Ujërat e zeza përmbajnë shumë lëndë që shpenzojnë oksigjenin e tretur, komponime të tretshme të fosforit dhe azotit, baktere dhe viruse patogjene, metale të rënda: Cd, Hg, Zn, Pb, Cr etj., si dhe materie të tjera që prishin cilësinë e ujit. Në bazë të valorizimit biologjik, të indikatorëve, kemi konkluduar se valorizimi i ujit që nga fshati Murgull e deri në Pollatë uji ka vlerë të mirë, kurse vlera e indeksit sillet nga 16-18, ndërsa nga fshati Kërpimëh e deri në qytetin e Podujevës uji ka vlerë mesatare dhe të dobët, vlera e indeksit sillet nga 9-15, prej Podujevës deri në fshatin Lum Madh - Komuna e Vushtrrisë uji ka vlerë të dobët, kurse vlera e indeksit është prej 6-13.¹⁸

Në liqenin e “Batllavës” problem është edhe shkarkimi i ujërave të zeza, për shkak se këto vendbanime nuk kanë të organizuar sistemin e pastrimit të ujërave. Liqeni i “Batllavës” përdoret për furnizim me ujë të pijshëm për qytetet e Podujevës, të Prishtinës, Fushë-Kosovës dhe Obiliqit.

18 Rizah Muçolli: Punim diplome. Tema: Ekologjia e ekosistemeve të ujërave rrjedhëse-tokësore, FSHMN, Prishtinë, 2005.

Problem serioz i gjendjes së tanishme është edhe shkarkimi i mbeturinave të amvisërisë dhe hedhurinave të tjerave në shtretërit e lumenjve për shkak të mos organizimit të grumbullimit të mbetjeve urbane. Shkarkimi i ujërave të zeza në rrjedhjet lumore pa trajtim paraprak rritë shkallën e ndotjes së lumit “Llap”. Mesatarisht çdo banorë shkarkon 16.46 m³/vit ujëra të zeza.

Komuna e Podujevës, me 122179 banorë, shkarkon 4.74 l/s, ose 5497m³ ujëra të zeza të pa trajtuara në lumë brenda ditës, pa llogaritur këtu objektet publike, tregtare, hoteliere, industriale etj.

Lumenjtë janë pjesa më e atakuar nga ndotja, ngase dominon logjika se lumi me masën e vet ujore bartë dhe largon gjithçka. Përveç ndotjes kimike të ujërave, është edhe ndotja fizike nga mbeturinat që nuk treten dhe përhapen në shtratin e lumit, e disa transportohen. Mbeturinave të ngurta që janë organike ndikojnë në ndotjen biologjike, që pas dekompozimit të tyre krijohen kushte të përshtatshme për jetesën e mikroorganizmave të ndryshëm, si dhe parazitëve që janë të dëmshëm për shëndetin e njeriut, florën dhe faunën që jeton në lumenj. Të gjitha këto lloje të ndotjeve i zvogëlojnë kushtet jetike për botën e gjallë që jeton në këto ujëra.

Shkarkimi i mbeturinave të ngurta në lumenj është dukuri tjetër negative në këtë Komunë. Kjo dukuri është e shprehur sidomos në ato vendbanime që nuk është e organizuar mbledhja e mbeturinave, por edhe mungesa e edukatës mjedisore.¹⁹

Degradimi i lumenjve

Në bazë të dhënave komunale, si dhe vërtetimeve në terren, shtretërit e lumenjve janë kthyer në deponi hedhurinash, si ato të amvisërisë, mbeturina ndertimore dhe mbetje të tjera urbane dhe rurale, pastaj shkarkimi i ujërave të zeza të vendbanimeve dhe industrisë si dhe nxjerrja e inerteve ka degraduar shtratin e lumenjve dhe ka ndikuar në cilësinë e ujit të lumenjve. Ndikim shumë të madh ka edhe uzurpimi i shtretërve të lumenjve dhe si pasojë ka ndodhur ndërrimi i rrjedhës natyrore të lumit, pastaj ndotja dhe shkatërrimi i biosferës në shtratin e lumit dhe përreth tij.

Pasojat e shfrytëzimit të inerteve në mënyrë të pa planifikuar në shtretërit e lumenjve shkaktojnë vërshime në tokat bujqësore dhe uljen e nivelit të ujërave nëntokësore.

Vet rritja e bimëve të larta, pengesat natyrore dhe ato antropogjenë kanë ndikuar negativisht në rrjedhën natyrore të lumit “Llap” dhe degët e tij.

Sipërfaqja ujore rreth 605ha në Komunën Podujevës, në bazë të vërtetimeve dhe në bazë të analizave të bëra në GIS, kanë pësuar ndryshime për shkak të uzurpimeve të shtratit të lumenjve dhe për shkak të mbjelljes së bimëve të larta nga fermerët që kanë pronat përgjatë shtratit të lumit.

Ndikimet negative antropogjenë janë prezentë në të gjitha rrjedhjet ujore që kalojnë në vendbanime nga hedhja e mbeturinave të ngurta, ku depozitimi i tyre shkakton degradim dhe ndotje që ndikon negativisht në arealin biogeografik të shtratit të lumit.

Hedhja e mbeturinave janë prezent në të gjithë lumenjtë e Komunës së Podujevës. Janë identifikuar këto pika degraduese në shtretërit e lumenjve: Repë, Bajçinë, Peran, Obranqë, Podujevë, Siboc i Epërm, Llugë, Lupç i Poshtëm. Këto janë pikat më të degraduara të shtratit të lumit “Llap”.

¹⁹ Të dhënat nga Plani Zhvillimor Komunal.

2.3 MENAXHIMI I MBETURINAVE

2.3.1 Mbeturinat urbane

Menaxhimi e mbeturinave e bënë KRM “Pastrimi”, shoqëria aksionare - Prishtinë, njësi operative në Podujevë. Kjo kompani i kryen shërbimet në qytetin e Podujevës dhe në disa fshatra, si në Sekiraj, Lluzhan, Shakovicë, Sallabajë, si dhe nga një pjesë të fshatrave Peran, Surkish dhe Llugë. Veprimtaria e tyre mund të shtrihet edhe në vendbanime të tjera me kërkesat e banorëve.

Nga KRM “Pastrimi” mesatarisht grumbullohen 22 000 kg mbeturina në ditë ose 400-440 tonë në muaj. Po që se merret mesatarja e sasisë së përgjithshme të mbeturinave për kokë banori për një ditë që në Kosovë është 2 kg, atëherë vlerësohet se sasia mesatare e prodhimit të mbeturinave në Komunën e Podujevës është 95632 kg /në ditë ose 34 905 680 kg në vit (34906 tonë).

Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Podujevës është një ndër sfidat më të mëdha të Komunës, si probleme të kësaj fushe janë pagesat e ulëta të faturave të mbeturinave gjë që vështirëson shtrirjen e shërbimit edhe në vendbanime të tjera.²⁰

2.3.2 Deponitë formale dhe informale

Deponia e mbeturinave gjendet në fshatin Dumnicë, e cila menaxhohet nga Kompania për Menaxhimi e Deponive në Kosovë (KMDK), është ndërtuar nga AER vitin në 2005. Në këtë deponi “varrosen” mbeturina të paklasifikuara mesatarisht 22 000 kg mbeturina në ditë ose 400-440 tonë në muaj. Po që se merret mesatarja e sasisë së përgjithshme të mbeturinave për kokë banori për një ditë që në Kosovë është 2 kg, atëherë vlerësohet se sasia mesatare e prodhimit të mbeturinave në Komunën e Podujevës është 95632kg /në ditë ose 34 905 680 kg në vit (34906 t).

Kjo deponi nuk i plotëson standardet për arsye se nuk qarkullon uji nga lagunat, por rrjedhë vazhdimisht në sipërfaqe të tokës, ku paraqet rrezik për atë lokalitet.

Deponitë ilegale - Këto deponi në vazhdimësi largohen nga Komuna në aksione të ndryshme, por fatkeqësisht qytetarët prapë hedhin mbeturina në ato vende ose vendet të tjera.

Si deponi ilegale konsiderohen edhe grumbulluesit e hekurit dhe baterive, të cilët janë në numër të madh dhe në vende të ndryshme pran rrugëve magjistrale, afër vendbanimeve etj.

Të gjithë këta operatorë nuk kanë leje pune nga Komuna, as licencë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Deponitë e hekurit dhe të baterive duhet të regjistrohen dhe t’ju nënshtrohen kriterëve për punë, në të kundërtën, duhet të mbyllen.

²⁰ Të dhënat nga Plani Zhvillimor Komunal.

2.4 ZHVILLIMI URBAN DHE SHFRYTËZIMI I TOKËS

2.4.1 Planifikimi hapësinor Komunal

Struktura hapësinore e territorit të Kosovës është ndarë në katër pjesë si:

1. Porti i Kosovës - zona e kaltër;
2. Thesari i Kosovës - zona e gjelbër;
3. Urat e Kosovës - zonat e verdha dhe;
4. Kopshtet e Kosovës - zonat e portokallta.

Komuna e Podujevës shtrihet gjeografikisht në hapësirën: Porti i Kosovës - zona e kaltër. Në këtë zonë kryesisht dominojnë: shërbimet administrative, arsimore, shëndetësore, shërbyese tregtare, industri e lehtë, agro-industriale, turistike etj.²¹



Figura 9. Harta - Porti i Kosovës – zona e kaltër

Komuna e Podujevës ka konceptin e zhvillimit të kombinuar (policentrik dhe linear)

Me këtë koncept Komuna e Podujevës është e organizuar me një qendër urbane (Podujeva), tri qendra sekondare (Orllani, Lluzhani, Kërpimehu), si dhe bashkësitë lokale.

Zonat dhe aktivitetet e tyre - Komuna e Podujevës karakterizohet me tri struktura (tërësi) kryesore hapësinore, të cilat kanë dallime të theksuara në aspektin ekonomik, social, mjedisor, të infrastrukturës dhe shërbimeve. Këto tri tërësi karakterizohen me veçoritë e tyre hapësinore specifike dhe potencialeve për zhvillimin e ardhshëm. Duke marr parasysh veçoritë e tyre natyrore, resurset dhe mundësitë zhvillimore, këto zona karakterizohen me funksione të veçanta. Zona Qendrore e Komunës është hapësira më e populluar, me veprimtari ekonomike të bazuara në agrikulturë biznese dhe shërbimet themelore të cilat i ofron.

²¹ Plani Hapësinor i Kosovës 2010 -2020 +, Prishtinë, 2010.

Zona veri-perëndimore paraqet një kompleks kryesisht malor, në të cilën zhvillimi do të mbështetet në veprimtaritë ekonomike të resurseve të natyrës dhe peizazheve, blegtorisë e turizmit, ndërsa zona lindore, kryesisht kodrinore malore dhe me potenciale ujore, paraqet bazë për zhvillimin e turizmit, blegtorisë dhe prodhimeve ekologjike-bujqësore.

1. Zona Qendrore- Aktive;
2. Zona Veri-Perëndimore- Malet dhe Peizazhet, dhe;
3. Zona Lindore-Kodrinat dhe Turizmi.



Figura 10. Harta - Strukturat hapësinore

1. Zona Qendrore-Aktive

Kjo zonë shtrihet kryesisht në pjesën qendrore të Komunës së Podujevës, në lartësi mbidetare deri në 700m. Përfshin pjesën fushore të Komunës, ku janë të koncentruar gati të gjitha aktivitetet, vendbanimet, popullsia, shërbimet, infrastruktura etj., për çka edhe është quajtur “Zona-Aktive”. Hapësira e kësaj zone zë sipërfaqen prej 19480 ha, që përfshin 31 % të territorit të Komunës.

Në këtë zonë shtrihen rreth 40 vendbanime, nga 78 sa ka gjithsej Komuna e Podujevës, ose 51.3 % e vendbanimeve shtrihen në këtë zonë. Në këtë zonë jetojnë rreth 90 000 banorë, ose 72.3 % e popullsisë së gjithmbarshme të Komunës. Në këtë zonë ndodhet edhe qendra komunale dhe njëherësh qendra e vetme urbane-Podujeva. Pothuajse shumica e aktiviteteve shoqërore-ekonomike zhvillohen në këtë zonë, ndërsa kjo dëshmon se “Zona-Qendrore” do të vazhdojë të jetë promotor i zhvillimit të Komunës. Boshti kryesor komunikativ, gegjësisht Autostrada Durrës – Merdare do të kalojë nëpër këtë zonë të Komunës, e cila do të ketë rol të rëndësishëm për zhvillimin e gjithmbarshëm të këtyre viseve. Por, krahas këtyre prioriteve, duhet të jemi të kujdesshëm për faktin se zgjerimi i hapësirave urbane dhe zhvillimi i bizneseve mund të jenë në konflikt me zhvillimin e agrikulturës për shkak të degradimit dhe zënies së tokës bujqësore me veti cilësore. Andaj, krahas zhvillimeve të ardhshme, mbrojtja e tokës bujqësore duhet të mbetet prioriteti i yni. Në bazë të gjitha këtyre potencialeve të lartpërmendura, kjo zonë është quajtur “Aktive”. Veprimtaritë kryesore ekonomike në këtë zonë janë: Agrikultura, industria, bizneset, shërbimet etj.

2. Zona Veri-perëndimore - “Malet dhe Peizazhet”

Pjesa më e madhe e kësaj zone i takon masivit malor të Kopaonikut, me sipërfaqe prej 27700 ha. Në këtë zonë gjenden vetëm 27 vendbanime me gjithsej 19.823 banorë, ose 16.4 % të popullsisë së Komunës. Pra, është një hapësirë që përbëhet kryesisht nga sipërfaqet pyjore me 15.421 ha, livadhet me 1266 dhe kullosat me 5651 ha. Zona malore e Shalës dhe Bajgorës karakterizohet me vlera natyrore dhe peizazhe tërheqëse për bukuritë natyrore.

3. Zona Lindore - “Natyra dhe Turizmi”

Zona e vlerave natyrore lindore shtrihet në terrenet kodrinore-malore të Gollakut dhe zë sipërfaqen prej 15690 ha. Në këtë zonë shtrihen 16 vendbanime me 12923 banorë, apo 10.7 % e popullsisë së Komunës. Në këtë zonë shtrihen kryesisht pyjet dhe kullosat, si dhe fondi i tokave bujqësore të kategorive III-VI-VII-VIII. Peizazhet natyrore në këtë zonë janë mjaft atraktive për rekreacion dhe turizëm. Mund të thuhet se pyjet dhe kullosat, uji-liqeni, janë resurset natyrore më të rëndësishme të “Zonës-Lindore” të Komunës.²²

2.4.2 Toka si medium mjedisor

Sipërfaqet e tokës:

• Tokë bujqësore	33.295 ha
• Tokë e punueshme	18.562 ha
• Kullosa	5.186 ha
• Livadhe individuale	7.598 ha
• Livadhe shoqërore	444 ha
• Djerrina	1.119 ha
• Tokë e zhveshur	150 ha
• Të tjera	9.547 ha
Gjithsej	75.901 ha

²² Plani Zhvillimor Komunal, Podujevë, 2010.

2.4.3 Bujqësia

Komuna e Podujevës ka resurse të jashtëzakonshme për zhvillimin e bujqësisë, pasi ka toka të mjaftueshme pjellore, ujë, si dhe një traditë të gjatë në këtë fushë. Përgjithësisht deri vonë bujqësia është llogaritur si një sektor sekondar pasi që i gjithë rendimenti është përdorur për nevoja të familjes.

Kohët e fundit vërehet një trend që kjo veprimtari është dhe mund të jetë edhe më profitabile. Ky duhet të jetë sektori strategjik për një qëndrueshmëri ekonomike lokale.

Bujqësia tash për tash nuk është ndonjë ndotës i madh në Komunën e Podujevës. Shumica e helmeve që përdoren janë helme kundër barojave të këqija, në sasi të vogël përdoren edhe insekticide për zhdukjen e insekteve të dëmshme.

2.4.4 Vendbanimet joformale

Pas lufte është ndërtuar Qendra e Përkohshme Kolektive (QPK) “Lagjia e Kuvajtit” në fshatin Balloc, ku janë të vendosura 132 familje me afër 700 banorë, në 18 kontejnerë me sipërfaqe rreth 5000 m². Kryesisht janë familje të dëshmorëve, jetimëve, skamnorëve.

Vendbanime të tjera joformale janë: Objekti banesor afër stacionit hekurudhor (jetojnë 22 familje), në rrugën “Lordi Bajron” në objektet e ish-ndërmarrjes “Ramiz Sadiku” (jetojnë 7 familje), në rrugën “Hyzdri Talla” në objektet montazh (baraka) (jetojnë 4 familje), tri vendbanimet e fundit jo formale janë uzurpuar pas lufte, nga këto familje të cilat jetojnë edhe sot.²³

2.4.5 Rekomandimet

Mbeturinat

- Duhet rritur shpenzimet dhe teknologjitë për mbledhjen e mbeturinave;
- Vënien në funksion të procesit të riciklimit të mbeturinave;
- Vazhdimin e rehabilitimit të sipërfaqeve me mbetje ilegale;
- Ndërtimi i një fushe të re të depozitimit, përpunimit dhe riciklimit të mbeturinave me komunat fqinje;
- Marrja e masave për mbledhjen, grumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve komunale;
- Sigurimin e Partneritetit Privat-Publik për përpunimin e riciklimit të mbeturinave;
- Iniciativa fiskale për sjellje miqësore ndaj mjedisit;
- Vazhdimi i mbjelljes së drunjtëve dhe shtimin e hapësirave të gjelbra;
- Marrja e masave për ruajtjen e hapësirave të hapura, bukurive natyrore;
- Marrja e masave për rehabilitimin e zonave të ndotura të mjedisit dhe hapjen e zonave të reja gjelbëruese, dhe;
- Organizimet në nivel komunal në bashkëpunim me OJQ-ët dhe partneritetin privatë – publik.

23 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Hapat që duhen ndërmarrë për riparimin e dëmeve mjedisore janë:

- Analiza e shtrirjes dhe natyrës së problemit – llogaritja e rrezikut;
- Shqyrtimi i alternativave që qojnë në një metodë të pëlqyer – vlerësimi i alternativave;
- Hartimi i detajuar i projektit që qon në një specifikim tenderi – përgatitja për programin e pastrimit;
- Vetëdijësimi i qytetarëve për aktivitetet jo legale dhe pasojat;
- Shtrirja e aktivitetit të Kompanisë për në vendbanimet e mëdha, si dhe ndarja në faza deri sa të mbulohet i tërë territori i Komunës;
- Mënjanimi dhe grumbullimi i të gjitha mbetjeve ilegale, dhe;
- Hartimi i rregullores komunale në bazë të Ligjit për Mbrojtje të mjedisit dhe funksionalizimi i Inspektoratit të Mjedisit në gjobitjen e veprimeve ilegale mjedisore.

Mbrojtja e lumenjve

- Pastrimi i shtretërve të lumenjve “Llap”, “Dumnica”, “Kaqandolli” dhe “Batllava”;
- Kontroll e përhershme nga inspektorati komunal dhe pajisja e tyre me mjete të nevojshme;
- Angazhimi i aksionit vullnetar për pastrim të mbeturinave nga lumi “Llap”, me degët e saj, si dhe hapësirës ujore të liqenit të “Batllavës” organizuar nga OJQ-të mjedisore dhe Komuna, Drejtoria e Arsimit, si dhe nga vet Komuniteti për vetëdijësim për ujëra;
- Shtrirja e rrjetit të kanalizimit në tërë zonën urbane;
- Shtrirja e rrjetit të kanalizimit në vendbanimet rurale dhe ndërtimi i kolektorve lokal;
- Përcaktimi i lokacionit varësisht se cili opsion është i përshtatshëm për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza;
- Ndarja e kanalizimit fekal nga ai i shirave;
- Ndërtimi i impiantit për trajtim të ujërave të zeza në përputhshmëri me standardet;
- Identifikimi i lokacionit më të përshtatshëm për ndërtimin e impiantit për pastrimin e ujërave të zeza në jug të qytetit dhe;
- Prioritet është mënjanimi i ujërave të zeza që shkarkohen në liqenin e “Batllavës”.

Rregullimi i shtretërve të lumenjve për parandalimin e vërshimeve

- Largimi i barrierave nga shtrati i lumenjve, qofshin ato natyrale apo të krijuara nga njeriu;
- Të bëhet meliorimi dhe pyllëzimi i brigjeve të lumenjve si masa parandaluese;
- Ndërtimi i kanaleve dhe /ose mureve mbrojtëse;
- Komuna do të ndërmarrë masat e nevojshme për kontrollimin e zhvillimit në tokat bujqësore përgjatë lumenjve, sidomos për ndërtimet dhe veprimet të tjera që mund ta rrisin rrezikun nga vërshimet;
- Mbrojtja e botës bimore në brigjet e lumenjve, prerja e domosdoshme do të lejohet vetëm në zonat ku ato do të mund të shkaktonin ndikime negative.
- Ndërmarrja e të gjitha veprimeve të nevojshme për përmirësimin e vlerave peizazhore të brigjeve të lumenjve përmes mbjelljeve dhe veprimeve për rregullim peizazhor për rekreim, si modelimi i terrenit dhe mbjellja e barit;
- Kontrollimi i eksploatimit të zhavorrit nga shtrati i lumenjve aty ku ka licencë për eksploatim, si dhe ndëshkimi i operatorëve ilegal të bëhet nga Inspektorati komunal me qëllim të parandalimit të ndotjes së ujit, shkatërrimit të botës shtazore të lumenjve dhe dëmtimeve të shtratit që mund të shkaktojnë vërshime, dhe;
- Çdo ndryshim i rrjedhës së lumit do të ndalohet nga Komuna dhe veprimet që mund të çojnë deri në rritjen e rrezeve nga vërshimet do të kontrollohen në mënyrë strikte.

Masat antierozive

Në bazë të analizave propozohen masat antierozive :

- Meliorimi i pyjeve - 11850 ha
- Brezi mbrojtës i shpateve - 18170 ha
- Mbrojtja ndërtimi i tarracave - 3498 ha
- Zonat e zhvillimit të punëve të antierozionit - 790.3 ha

Toka

- Organizimi i seminareve nga fusha e bujqësisë;
- Kontrolli i mbetjeve të natyrave të ndryshme;
- Kontrolli përdorimit të plehrave dhe pesticideve, dhe;
- Kontrolli dhe mënyra e përdorimit të tokave.

Trashëgimisë natyrore

- Parandalimi i ndërtimeve;
- Komuna në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të hartoj planet rregulluese për Pikën më turistike për Komunën “Liqenin e Batllavës”;
- Komuna së bashku me Institucionet e nivelit Qendror, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, duhet të përgatis planin menaxhues për mbrojtjen e integruar të natyrës. Plani duhet të mbroj çfarëdo zhvillimi që do të ketë efekte negative ndaj këtyre vlerave;
- Komuna në bashkëpunim me MKRS, të inicioj me akt të veçantë vënien nën mbrojtje lokalitetet arkeologjike;
- Të përpilohet katalogu i hartave për shfrytëzimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore për nevojat e turizmit;
- Pyjet dhe Biodiversiteti;
- Në bashkëpunim me MBPZHR/Agjencionin e pyjeve të ndërmarr masa strikte për parandalimin e prerjeve ilegale;
- Bashkëpunoj me MBPZHR për certifikimin e pyjeve private;
- Përgatis projektet për ripyllëzimin e sipërfaqeve të dëmtuara nga prerjet joligjore dhe zjarret me lloje bimore autoktone;
- Në bashkëpunim me njësinë Zjarrfikëse, SSPK, FSK, Njësinë e Ujësjiellit, Agjencionin e pyjeve dhe të gjithë faktorët relevant të krijohet shtabi i emergjencës në rast të paraqitjes së zjarreve në pyje;
- Të bëhen vlerësime nga ekspertët e pylltarisë për nevojat e rrallimit dhe prerjes sanitare të pyjeve në mënyrë që shfrytëzimi i pyjeve do të plotësojë nevojat e qytetarëve;
- Hartimi i planeve menaxhuese të pyjeve për periudha afatgjate;
- Ripyllëzimi ose ripërtëritja e kullosave të sipërfaqeve që kanë pjerrtësi më shumë se 15%;
- Sipërfaqet e identifikuara me erozion të mesëm, të lartë dhe shumë të lartë të pyllëzohen;
- Krijimi i brezave të gjelbër për gjatë shtretërve të lumenjve është masë parandaluese erozive dhe;
- Hulumtimet e tokës dhe përshtatja e fidanëve për pyllëzim dhe ripyllëzim

Masat për mbrojtjen e ajrit

- Largimi i të gjitha fermave të pulave nga vendbanimet dhe mos të lejohen në të ardhmen të ndërtohen në vendbanime;
- Largimi i të gjitha stallave të bagëtive nga vendbanimet dhe mos të lejohen në të ardhmen të ndërtohen në vendbanime;

- Të largohen nga qyteti të gjitha bizneset që shkaktojnë ndotje në mjedis, si fabrika e betonit, auto-serviset e ndryshme, depot e hekurit , depot e plastikës etj.;
- Monitorimi dhe ulja e ndotjes së ajrit nga të gjitha bizneset që shkaktojnë ndotje;
- Të organizohet sistemi për menaxhimin e mbeturinave të kafshëve;
- Zbatimi i përpiktë i standardeve të larta në ndërtimin e kapaciteteve të reja për prodhim të energjisë që konsumohet në amvisëri dhe bizneset e vogla (shërbime publike) dhe arritjen e detyrimeve nga marrëveshja e KYOTO-s;
- Të krijohet baza e të dhënave, për kalkulimin e ndotësve të emituar në ajër nga impiantet me djegie të vogël dhe baza e të dhënave për cilësinë e ajrit në tërë territorin e Komunës;
- Zëvendësimi i modaliteteve të ndryshme të transportit me mjete më të pastra të transportit, më pak trafik motorik, më shumë transport publik, çiklizëm;
- Metoda të tjera për zvogëlimin e emisioneve si p.sh. pastrimi i rrugëve, shfrytëzimi i karburanteve të pastra dhe inspektimi i veturave, dhe;
- Fushata për vetëdijesimin e publikut.

III. BIODIVERSITETI DHE TRASHËGIMIA NATYRORE

3.1 Biodiversiteti

Kushtet pedologjike, klimatike, lartësia e shprehur mbidetare kanë ndikua që të ketë lloje të ndryshme bimore dhe shtazore. Ky biodiversitet më karakteristik është për pjesën e maleve të Kopaunikut. Në zonat malore dhe kodrinore malore dominojnë pyjet, ka edhe sipërfaqe të zhveshura e barishta. Prej drunjtëve dallohen pyjet gjetherënëse, si: ahu (*Fagus sylvatica*), qarri (*Quercus ceris*), bungu, shkoza (*Carpinus orientalis*). Disa trunge sipas Institutit për Mbrojtjen e Natyrës janë shpallur si monumente natyrore, si plepi në Bajqinë, plepi Orllan, trugu i qarrit në Pollatë, Dumnice dhe Dobratin. Trugjet e ahut janë me dimensione mjaft të mëdha (gjatësia dhe trashësia e drurit). Përhapje më të kufizuar kanë llojet tjera që paraqiten si të vetmuara, si: brekia, bliri (*Tilia cordata*), frashri etj. Përhapje kanë edhe tipet tjera që janë të ulëta, sikurse lloji i shkurreve: thana (*Cornus mas*), murri (Crataegus monogyna), kaça (*Rosa canina*), manaferra e egër (*Rubus fruticosus*), shtogu (*Sambucus nigra*), kulumbria (*Prunus spicosa*), lajthia (*Corylus avellana*), në vise të larta fieri shqiponje (*Pteridium aquilinum*) etj.

Nga bimët barishtore dallohen lloje të ndryshme, si ato që rriten në ambient të hapur pa prezencë të drunjtëve, si edhe ato që rriten brenda pyjeve. Këtu rriten edhe bimë që përdoren në mjekësinë popullore, që përdoren, si çaj: çaji i malit (*Origanum vulgare*), kantarioni (*Hypericum perforatum*), kamomili (*Matricaria chamomila*), dredhëza (*Fragaria vesca*) etj. Prej drunjtëve gjethembajtëse janë mbjellur disa hapësira pranë liqenit të “Batllavës”, mandej afër fshatit Dobërdol.

Në hapësirat e rrafshëta të Komunës, fushëgropën e “Llapit” zakonisht rritet shëlg (Salix alba) në brigje të lumenjve, si dhe plepi që u përmend më lartë. Bimë të ulëta ka mjaft, si lulëkuqja që rritet zakonisht në grunaja (Papaver rhoeas), hithi (Urtia dioica) formacionet e livadheve, si tërfili dhe shkurre të rralla.

Fauna është me mjaft lloje që nuk janë karakteristike vetëm e këtyre hapësirave. Në pyje jetojnë: ujku (Canis lupus), derri i egër, dhelpra, lepu (Lepus europaeus), iriqi (Ernaceus europeus) etj. Kohët e fundit, jo vetëm në këtë hapësirë, ka filluar të paraqitet kaprolli (Capreollus chrysaetos), i cili dikur ka qenë mjaft i përhapur.

Prej shpezëve jetojnë mjaft lloje, si: trishtili kokëzi (parus major), zogu i malit, pëllumbi i egër (Columba livia), qukapikthi (Dryobates major), laraska (Pica pica), qyqja (Cuculus canorus) etj. Shpezë grabitqare që jetojnë janë: shqiponja e zezë (Aquilachyretos), petriti (Malco tinnunculus). Shpezë shtegtarë që jetojnë janë: dallëndyshja, lejleku etj.

Në lumenj jeton gjarpri i ujit (Natrix natrix), gurit (Vipera ammodytes), bollujca (Tropidonatus natrix), kërmilli i vreshtës (Helix pomatia), breshka e rëndomtë (Testudo bermanni). Sipas hulumtimeve të bëra nga Gashi 2006, në lumin “Llap” hasen këto lloje të peshqve: trofta (Salmo trutta m. Fario), mustaku (Barbus barbus), mlyshi (Squalius cephalus), gjuca (Leucaspius deleneatus), barburiri (Gobio gobio), karashi (Carassius gibelin), njila (Chondrostoma nasus), krapi i egër (Cyprius carpio), lloska (Scardinius erythrophthalmus), sharroku (Perca fluviatilis), lina (Tinca tinca) dhe vimba (Vimba vimba). Pjesë të kësaj Komune shfrytëzohen për gjuajtje peshku sportive në liqenin e “Batllavës” dhe brigjeve të lumit “Llap”. Insekte ka shumë lloje, si janë: fluturat, milingonat që bëjnë koloni dhe janë disa lloje merimanga, kacadreri (Lucanus cervus) etj.

3.2 Trashëgimia natyrore

Llojllojshmëria e monumenteve natyrore të karakterit botanik, hidrologjik, gjeomorfologjikë të Komunës së Podujevës, si dhe peizazheve të ndryshme natyrore që kanë përhapje në territorin e Komunës, konsiderohen vlera të një trashëgimie natyrore. Deri më tani nuk ka pas hulumtime të natyrës në këtë Komunë. Vlerat e trashëgimisë natyrore, edhe pse pa mbrojtje institucionale të mjaftueshme, i kanë mbijetuar kohës.

Gjatë periudhës 2002-2006, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, ka bërë hulumtimin dhe evidentimin vlerave të reja të natyrës në 16 Komuna të Kosovës. Këto vlera janë evidente edhe në Komunën e Podujevës, ku këto zona janë propozuar për mbrojtje institucionale, për shkak vlerave të larta dhe të veçanta. Komuna e Podujevës ka poseduar një liste me 8 objekte të mbrojtura qysh nga vitet e '60-ta, mirëpo fatkeqësisht disa prej tyre nuk gjenden në gjendje të mirë për shkak të ndikimit të faktorëve të ndryshëm antropogjen dhe jo antropogjen. (Tabela 12)

Tabela 12. Trashëgimia natyrore

Emri i Objektivit	Vendi	Sipërfaqja në ha	Viti i mbrojtjes	Kategoria	Përshkrimi i vlerave
1. Lisi i Qarrit (Quercus Cerris).	Dobratin		1988	III	Monument natyror me karakter botanik.
2. Trungu i Plepit (Populus tremula).	Bajqinë		1959	III	Monument natyror me karakter botanik.
3. Trungu i Qarrit (Quercus cerris).	Pollatë	00.44,20	1988	III	Monument natyror me karakter botanik.
4. Trungu i Plepit (Populus tremula).	Orllan	00.26,20	1988	III	Monument natyror me karakter botanik.
5. Burimi i ujit natyror.	Revuqë	1.16,94	1988	III	Monument natyror me karakter hidrologjik.
6. Trungu i Qarrit (Quercus cerris).	Dumnicë të Poshtme		1988	III	Monument natyror me karakter botanik.
7. Burimi i ujit termo-mineral.	Shakovicë	1.40,54	1988	III	Monument natyror me karakter hidrologjik.
8. Burimi i ujit mineral.	Sallabajë	00.31,47	1988	III	Monument natyror me karakter hidrologjik.

Lista e objekteve (zonave) natyrore të cilat Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës - IKMN i ka propozua për mbrojtje:

1. Lugina dhe Qafa e Kaqandollit, Kaqandoll (Podujevë-Mitrovicë-Vushtrri);
2. Lokaliteti "Ushton Reka", Popovë;
3. Kompleksi i liqenit të "Batllavës", Orllan-Batllavë;
4. Vrella e Dobratinit dhe Kompleksi i trunqeve të ahut dhe të dushkut, Dobratin (Lagja e Ajvazëve);
5. Trungu i Plepit, Murgullë;
6. Dy trunqe të dushkut, Llapashticë e Epërme, (varrezat e fshatit);
7. Trungu i Plepit, Orllan;
8. Trungu i dushkut, Dyz dhe;
9. Trungu i plepit, Gërdoc.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës – IKMN në vitin 2006 i ka dorëzuar Kuvendit Komunal të Podujevës arsyeshmërinë profesionale të këtyre vlerave natyrore e (me përjashtim të tri zonave të para në listë, e të cilat ende pritet të shpallen vlera natyrore të mbrojtura, secila zonë sipas kategorisë përkatëse.





Fig11. Harta - Trashëgimia natyrore

Pjesa 4

IV. REZULTATET E ANKETËS PËR PRIORITETET

Pesë problemet kryesore në fushën e mjedisit në Komunën tuaj?



V. Lista e problemeve prioritare sipas respondentve

1. Mungesa e hapësirave të mjaftueshme gjelbëruese ujërat e zeza;
2. Mungesa e ujit të pijshëm;
3. Menaxhimi jo adekuat i mbeturinave;
4. Zhurma;
5. Degradimi i natyrës dhe prerja e pyjeve;
6. Degradimi i tokës bujqësore dhe ndërtimet e reja pa kritere urbanistike në zonat urbane;
7. Vendosja pa kritere e antenave të operatorëve të ndryshëm;
8. Mungesa e vetëdijesimit për ruajtjen e mjedisit dhe;
9. Mos zbatimi i legjislacionit.

Si probleme të tjera mjedisore respondentët nga Podujeva kanë theksuar edhe këto probleme: mos angazhimi i personave adekuat në mbrojtje të mjedisit, mos mirëmbajta e lagjeve periferike, mungesa e kontejnerëve, mos menaxhimi i ujërave të shiut, mungesa e qendrave informuese për mjedisin, mungesa e trotuareve, mungesa e hapësirave rekreative sportive, mungesa e parqeve nacionale, ndotja e lumit “Llap”, mungesa e tualeteve publike, ndotja nga vetë qytetarët, parkingu i veturave në trotuar dhe zhurma nga gjeneratorët.

Pjesa 5

VI. Plani i Veprimit – Projektet prioritare

Nr	Projekti	Bartësi i projektit	Buxheti total (Euro)	Objektivat	Periudha zbatuese	Rezultatet e pritura
1	Hartimi dhe Miratimi i rregullore komunale për mjedis.	Komuna.	5 000	Rregullore me standarde evropian dhe funksionale.	2013	Menaxhimi i Mjedisit për zhvillim të qëndrueshëm.
2	Pako e Gjellbër e lëndës mësimore në të gjitha shkollat.	Komuna.	2 000	Njohuri mjedisore të qytetarëve përmes Pakos së Gjellbër.	2012	Ngritja e vetëdijes së qytetarëve.
3	Rregullimi dhe gjellbërimi i hapësirave publike përreth blloqeve banesore, afër QKMF në Podujevë.	Komuna dhe donatorët.	60.000	Vend atraktiv, kreativ për banorët e lagjes.	2012	Pamje më e bukur e qytetit; Vend për pushim dhe aktrim dhe; Mjedis i pastër.
4	Hartimi i Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave.	Komuna.	5.000	Plani detal dhe funksional për menaxhim.	2013	Menaxhim i mirë i mbeturinave dhe; Zvogëlim i nr. të deponive ilegale.
5	Sistemi i grumbullimit të mbeturinave i shtrirë në të gjitha fshatrat.	Komuna dhe KMR “Pastrimi”.	8 .000	Grumbullimi i mbeturinave në çdo shtëpi.	2013	Menaxhim i mirë i mbeturinave dhe; Ambient i pastër në të gjitha fshatrat.
6	Riciklimi i mbeturinave në institucione.	Komuna dhe donatorët.	50 000	Ndarja e mbeturinave për riciklim në të gjitha institucionet publike.	2013	Ngritja e vetëdijes për riciklim dhe; Më pak mbeturina të dërguara në deponi.
7	Hartimi i projektit për ndërtimin e deponisë të materialeve ndërtimore.	Komuna.	5.000	Projekti i deponisë të materialit ndërtimorë.	2013	Plani detal dhe funksional për menaxhim e mbeturinave ndërtimore.
8	Ndërtimi i një deponie të materialeve ndërtimore.	Komuna dhe donatorët.	600 000	Ambienti i pastër nga mbeturinat ndërtimore.	2013	Eliminimi i deponive të egra të materialit ndërtimorë.
9	Për çdo vit të pyllëzohen nga tetë (8) ha të sipërfaqeve të zhveshura.	Komuna dhe MBPZHR.	75 000	Pyje të bukura, të mbrojtura në funksion të baraspeshës ekologjike.	2012, 2013, 2014, 2015, 2016	Ajër i pastër, rritja e sasisë së ujit dhe; Ulje e CO2 dhe rritje O2.

10	Furnizim me ujë të pijshëm për fshatin Peran.	KUR "Prishtina", Komuna dhe donatorët.	61 500	Rreth 2 000 banorë shfrytëzojnë ujin e ujësjellësit publik.	2011-2014	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet e ujit të papastër.
11	Furnizim me ujë të pijshëm për fshatin Bradash.	KUR "Prishtina", Komuna dhe donatorët.	177 000	Rreth 3 000 banorë shfrytëzojnë ujin e ujësjellësit publik.	2011-2014	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet e ujit të papastër.
12	Furnizim me ujë të pijshëm për fshatin Bajqinë.	KUR "Prishtina", Komuna dhe donatorët.	157 000	Rreth 2 000 banorë shfrytëzojnë ujin e ujësjellësit publik.	2011-2014	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet e ujit të papastër.
13	Furnizim me ujë të pijshëm për fshatin Dobërdol.	KUR "Prishtina", Komuna dhe donatorët.	130 500	Rreth 2 000 banorë shfrytëzojnë ujin e ujësjellësit publik.	2011-2014	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet e ujit të papastër.
14	Furnizim me ujë të pijshëm për fshatin Dobratin.	KUR "Prishtina", Komuna dhe donatorët.	260 000	Rreth 2 500 banorë shfrytëzojnë ujin e ujësjellësit publik.	2011-2014	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet e ujit të papastër.
15	Furnizim me ujë të pijshëm për fshatin Orllan.	KUR "Prishtina", Komuna dhe donatorët.	301 000	Rreth 1600 banorë shfrytëzojnë ujin e ujësjellësit publik.	2011-2014	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet e ujit të papastër.
16	Furnizim me ujë të pijshëm për fshatin Llapashiticë II.	KUR "Prishtina", Komuna dhe donatorët.	211 000	Rreth 2 500 banorë shfrytëzojnë ujin e ujësjellësit publik.	2014-2016	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet e ujit të papastër.
17	Furnizim me ujë të pijshëm për fshatin Llaushë.	KUR "Prishtina", Komuna dhe donatorët.	149 500	Rreth 1 300 banorë shfrytëzojnë ujin e ujësjellësit publik.	2014-2016	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet e ujit të papastër.
18	Furnizim me ujë të pijshëm për fshatin Obranqë II.	KUR "Prishtina", Komuna dhe donatorët.	123 000	Rreth 3 000 banorë shfrytëzojnë ujin e ujësjellësit publik.	2014-2016	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet e ujit të papastër.
19	Furnizim me ujë të pijshëm për fshatin Katunishtë.	KUR "Prishtina", Komuna dhe donatorët.	131 500	Rreth 1 500 banorë shfrytëzojnë ujin e ujësjellësit publik.	2014-2016	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet e ujit të papastër.
20	Rregullimi i parkut të paqes.	Komuna dhe donatorët.	200 000	Rritja e sipërfaqeve për rekreacion.	2014	Park funksional dhe atraktiv.

21	Rregullimi i hapësirës gjelbëruese të furra e hashkalive.	Komuna dhe donatorët.	30 000	Rritja e sipërfaqeve gjelbëruese.	2013	Pushimore atraktive.
22	“Shenjëzimi i dhe thurja e objekteve natyrore”.	Komuna dhe MMPH.	50 000	Ruajtja e vlerave natyrore.	2013	Shenjëzimi i të gjitha objekteve natyrore.
23	Stacione matëse për cilësinë e ajrit.	MMPH.	100 000	Monitorimi i ajrit.	2014	Rritja e cilësisë së ajrit.
24	Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Obranqë.	Komuna dhe donatorët.	73 000	Mirëqenia sociale.	2011 -2013	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet infektuese.
25	Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Dumnicë e Poshtme.	Komuna dhe donatorët.	70 000	Mirëqenia sociale.	2012	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet infektuese.
26	Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Orllan.	Komuna dhe donatorët.	450 500	Mirëqenia sociale.	2011 -2013	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet infektuese.
27	Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Dobratin.	Komuna dhe donatorët.	43 000	Mirëqenia sociale.	2011 -2013	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet infektuese.
28	Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Bellopojë.	Komuna dhe donatorët.	40 500	Mirëqenia sociale.	2013 -2014	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet infektuese.
29	Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Tërnavë.	Komuna dhe donatorët.	51 000	Mirëqenia sociale.	2013 -2014	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet infektuese.
30	Mbëltimi i drunjve dekorativ nëpër rrugë të qytetit.	Komuna dhe donatorët.	20 000	Shëndeti më i mirë i qytetarëve.	2013	Rritë sasinë e Oksigjenit, rritë lagështinë e ajrit, ulë nr. e baktereve.
31	Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Llapashticë e Epërme.	Komuna dhe donatorët.	78 500	Mirëqenia sociale.	2013 -2014	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet infektuese.
32	Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Llapashticë e Poshtme.	Komuna dhe donatorët.	60 000	Mirëqenia sociale.	2013 -2014	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet infektuese.
33	Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Gërdofc.	Komuna dhe donatorët.	106 500	Mirëqenia sociale.	2014 -2016	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet infektuese.

34	Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatrat Sibofc i Epërm dhe i Poshtëm.	Komuna dhe donatorët.	115 700	Mirëqenia sociale.	2014 -2016	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet infektuese.
35	Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Sfeqël.	Komuna dhe donatorët.	131 500	Mirëqenia sociale.	2014 -2016	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet infektuese.
36	Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Revuq.	Komuna dhe donatorët.	34 900	Mirëqenia sociale.	2014 -2016	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet infektuese.
37	Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Sallabajë.	Komuna dhe donatorët.	78 500	Mirëqenia sociale.	2014 -2016	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet infektuese.
38	Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatrat Pakashticë e Epërme dhe e Poshtme.	Komuna dhe donatorët.	81 800	Mirëqenia sociale.	2014 -2016	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet infektuese.
39	Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Dyzë.	Komuna dhe donatorët.	70 300	Mirëqenia sociale.	2014 -2016	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet infektuese.
40	Ndërtimi i kolektorit kryesor që do shtrihet përgjatë lumit "Llap".	Komuna dhe donatorët.	500 000	Mirëqenia sociale.	2014-2016	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet infektuese.
41	Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Lupç i Epërm.	Komuna dhe donatorët.	35 000	Mirëqenia sociale.	2016-2018	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet infektuese.
42	Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Majac.	Komuna dhe donatorët.	96 500	Mirëqenia sociale.	2016-2018	Ulja e numrit të sëmurëve nga sëmundjet infektuese.
